



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 572 Akti

Nr. 687 Vendimi  
Tiranë, më 21.7.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Firdes Shuli</b>	Relatore
<b>Olsi Komici</b>	Anëtar

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në datën 19.7.2023, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Artur Cara**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

1. Z. Artur Cara është subjekt i rivlerësimit sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2020,
3. Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Cara, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Kualifikuar (AKSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
5. Pas administrimit të raporteve, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Artur Cara, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine.
6. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
7. Në datën 20.6.2023, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Cara; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
8. Në datën 23.6.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë shpjegime dhe prova mbi konstatimet e Komisionit; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti ka paraqitur shpjegimet dhe provat brenda afatit të caktuar.

## I. SEANCA DËGJIMORE

9. Në datën 19.7.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.
- 9.1 Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 21.7.2023.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**10.** ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Në përfundim të veprimeve verifikuese, ILDKPKI-ja ka dërguar raportin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Cara, ku ka arritur në konkluzionin se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime të financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**11.** Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimet nr. 2 e nr. 17 të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

**12.** Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore të administruara dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për pasuritë e subjektit dhe personave të lidhur me të, ka rezultuar si vijon:

#### **13. Automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë në datën 18.1.2017, në vlerën 5.700 euro**

Burimi i krijimit në deklaratën *Vetting*: kredia e re e shtuar në vlerën 21.000 euro. Shlyer sipas transfertës bankare në datën 23.1.2017. Vlera: 5.700 euro.

#### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

**13.1** Sipas të dhënave të DPSHTRR-së, shtetasja S. B. ka blerë automjetin nga shtetasja A. M., me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.4.2014, në shumën 550.000 lekë.

**13.2** Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2017, shtetasja S. B. i shet shtetasit Artur Cara automjetin tip “Daimler Chrysler” me targë \*\*\*, në vlerën 5.700 euro, regjistruar në emër të subjektit sipas certifikatës së pronësisë datë 1.3.2018.

**13.3** Me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.3.2018, automjeti i është shitur shtetasit A. Z. në shumën 5.000 euro.

**13.4** Pas verifikimeve nuk rezultoi gjendje konflikti interesi me palët e kontratave të shitblerjeve.

**13.5** Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kredinë në vlerën 21.000 euro. Nga verifikimi i dokumenteve bankare rezulton se subjekti ka marrë një kredi pranë Credins Bank sipas kontratës së kredisë datë 19.12.2016 dhe shuma 21.000,00 euro është disbursuar në datën 21.12.2016 në emër të z. Artur Cara.

**13.6** Po kështu vërtetohet transferimi i fondeve në favor të shitëses S. B. në vlerën 5.700 euro, datë 23.1.2017, me përshkrimin “Kalim për likuidim detyrimi sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.”. Pra është paguar çmimi i shitjes, sikurse është parashikuar në kontratën e shitjes.

**13.7** Komisioni verifikoi përdorimin e këtij automjeti në pronësi të vajzës së dajës së bashkëshortes para blerjes së tij dhe nga verifikimi në sistemin e AMF-së subjekti i rivlerësimit nuk figuron si përdorues i tij, ndërkohë shtetasja S. B. , e cila figuron pronare e automjetit në periudhën që e ka pasur në pronësi, nuk rezulton të ketë mjet tjetër në pronësi.

**13.8** Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë pasuri.

#### **14. Lidhur me apartamentin me sip. 120 m<sup>2</sup>, ndodhur në Laprakë, Tiranë**

Burimi i krijimit për këtë pasuri: aktmarrëveshja paraprake datë 13.9.2002. Vlera: 38.000 USD. Pjesa takuese: 50%.

#### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

**14.1** Me aktmarrëveshjen datë 13.9.2002, lidhur mes sipërmarrësit “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palës porositëse Artur dhe R. Cara, pala porositëse kërkon nga sipërmarrësi ndërtimin e një apartamenti 3+1, nr. \*\*\*, me sip. 120 m<sup>2</sup>, që ndodhet në objektin \*\*\*, kundrejt vlerës 38.000 USD.

**14.2** Sipas marrëveshjes datë 13.9.2002 ishte likuiduar vlera prej 16.400 USD dhe pjesa tjetër do të likuidohej brenda vitit 2003.

**14.3** Kontrata përfundimtare e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., u nënshkrua nga palët në datën 17.7.2009. Sipas kësaj kontrate, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i ka shitur shtetasve Artur dhe R. Cara. pasurinë apartament me sip. 120 m<sup>2</sup>, me çmim 38.000 USD.

**14.4** Sipas vërtetimit hipotekor datë 27.10.2009, pasuria nr. \*\*\*, me sip. 120 m<sup>2</sup>, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve Artur dhe R. Cara, pasuri për të cilën është lëshuar edhe kartela e pasurisë dhe certifikata e pronësisë datë 21.12.2016, e ZVRPP-së Tiranë.

**14.5** Në DPDFD-në e vitit 2009, me funksion prokuror nga data 10.12.2009, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri me burim krijimi të ardhura të akumuluar në vite.

**14.6** FSHU-ja ka konfirmuar se me gjeneralitetet Artur Cara figurojnë 4 abonentë, nga të cilët dy janë në instancën Kavajë, një në Burrel dhe një në Tiranë. Subjekti ka vërtetuar me dokumentacion ligjor provues pas kalimit të rezultateve të hetimit se kontratat e lidhura në instancat Kavajë dhe Burrel nuk janë për pasuri në pronësi të tij.

**14.7** Nga të dhënat e administruara nga FSHU-ja rezulton kontrata me nr. \*\*\* në emër të shtetas R. M. L., e çelur në datën 11.9.2003, me adresë kabina “\*\*\*\*”.

#### **Lidhur me çmimin dhe mënyrën e likuidimit**

**14.8** Sipas aktmarrëveshjes datë 13.9.2002, vlera e plotë e apartamentit është 38.000 USD, prej së cilës 16.400 USD paguar *cash* me lidhjen e kontratës, pjesa tjetër e vlerës do të paguhej për 10 muaj, në çdo datë 20, në vlerën 2.160 USD.

**14.9** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se me aktmarrëveshjen datë 13.9.2002 është likuiduar shuma prej 16.400 USD dhe pjesa tjetër brenda vitit 2003.

**14.10** Edhe në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar vlerën 38.000 USD dhe se pagesat janë kryer gjatë viteve 2001 – 2003.

**14.11** Në DPFĐ-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar se çmimi është paguar në vitet 2001 – 2002.

**14.12** Nga verifikimet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk rezulton që nga subjekti i rivlerësimit të jetë kryer ndonjë veprim hetimor si OPGJ, ku palë të kenë qenë shtetasi H. V. dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**14.13** I pyetur gjatë procesit mbi kohën e saktë dhe mënyrën e pagesës së diferencës së mbetur prej 2.700 USD të çmimit të blerjes, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se kjo diferencë është likuiduar para nënshkrimit të kontratës deri në fund të vitit 2002, duke shpjeguar se disponon vetëm faturat e pagesave, vënë në dispozicion Komisionit me përgjigjet e këtij pyetësi, fatura të cilat ishin administruar si pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

**14.14** Në përfundim të hetimit, pagesat e kësteve të çmimit u konsideruan sipas mandatarkëtimeve të administruara, në datat e këtyre akteve. Ndërsa, shuma 2.700 USD është konsideruar si shpenzim në fund të vitit 2002 (dhjetor).

### **Lidhur me shpenzime të tjera për investime në pasuri**

**14.15** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se në vitin 2010 ka kryer arredimin e dhomës së fëmijëve, si dhe punime për shkak të lagështirës dhe problematikave në sistemin e ngrohjes të instaluar në dysheme dhe se për këto investime kryesisht ka shërbyer kredia bankare në Credins Bank në maj të vitit 2010.

**14.16** Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar edhe një kredi të marrë pranë Credins Bank në datën 17.5.2010, në shumën 15.000 euro, objekti i së cilës është për shlyerje detyrimi për apartamentin ku banon në Laprakë.

**14.17** Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në datën 19.2.2016, subjekti ka deklaruar se kredia në shumën 15.000 euro, datë 17.5.2010, është marrë për arredim dhe sistemim banese, qëndrim i mbajtur edhe gjatë procesit.

**14.18** Nga dokumentet bankare rezulton se kredia është disbursuar në datën 19.5.2010, në shumën 15.000 euro, e cila është tërhequr *cash* nga subjekti, përkatësisht: në datën 19.5.2010 shuma 10.000 euro; në datën 21.5.2010 shuma 4.700 euro.

**14.19** Me qëllim verifikimin e qëllimit të marrjes së kredisë, me kërkesë të Komisionit, Credins Bank konfirmon se subjekti dhe bashkëshortja e tij, në cilësinë e dorëzanëses, janë financuar me një kredi në shumën 15.000 euro, disbursuar më 19.5.2010.

**14.20** Në dosjen e kredisë, në formularin e aplikimit të firmosur nga subjekti, qëllimi i kredisë është cilësuar “pagesë këst apartamenti”, ndërkohë në dokumentin “raport analize”, të firmosur nga punonjësit e bankës, qëllimi i kredisë është cilësuar “blerje banese”.

**14.21** Në këtë dokument, tek plani i investimit cilësohet se: “Z. Artur në datën 18.7.2009 lidhi kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 120 m<sup>2</sup>, në adresën rruga “\*\*\*\*”, blloku “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Tiranë, në vlerën 38.000 USD. Sipas kësaj kontrate thuhet se vlera totale e detyrimit është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Z. Artur pohon se një pjesë e pagesës janë likuiduar para nënshkrimit të kontratës me fondet e vetë klientit, ndërsa pjesa tjetër është financuar me një hua nga një i afërm i tij. Për këtë arsye z. Artur po aplikon pranë bankës tonë për një kredi në shumën 15.000 euro, me qëllim likuidimin e detyrimit ndaj të tretëve”. Ndërsa në kontratën e kredisë me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.5.2010, qëllimi i kredisë është “investim blerje shtëpie”.

**14.22** Nisur nga sa më sipër, Komisioni kërkoi sqarime nga subjekti në lidhje me: (i) cilësimin “pagesë këst apartamenti”, ndërkohë që likuidimi i çmimit të shitjes së pasurisë ka përfunduar brenda vitit 2003, sipas mandatpagesave të paraqitura nga vetë ai; (ii) destinacionin e përdorimit të kredisë; (iii) huan që duket të jetë marrë nga një i afërm i tij, duke identifikuar emrin e huadhënësit dhe burimin e të ardhurave të tij për dhënien e huas, shoqëruar me dokumente që vërtetojnë të ardhura të ligjshme të tij; (iv) destinacionin e kësaj huaje dhe përse nuk është kryer asnjë deklaram në lidhje me këtë hua nga ana e tij.

**14.23** Në përgjigje të datës 14.6.2023, subjekti sqaron: “*Apartamenti me vlerë 38.000 USD ka qenë shlyer para aplikimit për kredi, sipas mandatpagesave që janë depozituar pranë Komisionit, ku ka sqaruar edhe burimin e krijimit. Ajo që është konstatuar nga ana e Komisionit në dokumentacionin bankar të kredisë nuk pasqyron drejt qëllimin e kësaj kredie. Nuk mund të jap një përgjigje të saktë për mënyrën e përpilimit të dokumentit nga ana e bankës, nëse ka qenë model standard apo është punuar mbi një model të mëparshëm, por fakti është që nuk pasqyron saktë qëllimin e marrjes së kredisë. Nuk ka qenë konstatuar nga ana ime në momentin e kryerjes së veprimeve, pasi kam qenë fokusuar te vlera dhe plani i pagesave të kësteve të kredisë*”. Ai rikonfirmon se qëllimi i marrjes dhe destinacioni kryesor i përdorimit të kredisë ka qenë ai që ka shpjeguar në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, pra për arredimin dhe rregullimet e kryera në vitin 2010.

**14.24** Sa i takon kredisë së marrë në vitin 2010, në formularin e aplikimit të firmosur nga subjekti, qëllimi i kredisë është cilësuar “pagesë këst apartamenti”. Po kështu, qëllimi i kredisë së marrë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.5.2010, është “investim blerjeje shtëpie”. Në kushtet kur shlyerja e apartamentit në Laprakë kishte përfunduar në vitin 2003, kredia e datës 17.5.2010 nuk mund të jetë përdorur për pagesat e blerjes së këtij apartamenti. Ndërkohë që sipas përshkrimit në dokumentet e bankës kjo kredi është marrë me qëllim shlyerjen e huas, e cila ishte marrë për blerjen e apartamentit me kontratë shitjeje të vitit 2009, i vënë si garanci hipotekore për shlyerjen e kredisë.

**14.25** Kredia prej 15.000 euro, përfituar në vitin 2010, është vlerësuar nga Komisioni se është përdorur si burim për sistemim dhe arredim të pasurisë objekt verifikimi gjatë këtij viti.

**Lidhur me burimin e të ardhurave për apartamentin me sip. 120 m<sup>2</sup>, rezulton se:**

- Në DPDFD-në e vitit 2009 ka deklaruar si burim krijimi të ardhura të akumuluar në vite.
- Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 19.2.2016, si burim ka deklaruar kursimet nga puna e tij në Itali gjatë viteve 1995 – 1999, puna në Shqipëri nga viti 2000 e në vazhdim dhe puna e bashkëshortes nga viti 1995 e në vazhdim.
- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhura nga puna e tij dhe në aktivitet privat në Itali prej vitit 1995, si dhe të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi në shoqëritë e biznesit privat “\*\*\*\*” sh.p.k dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. prej vitit 1995.

**14.26** Nga hetimi ka rezultuar se subjekti gjatë nënshkrimit të kontratës ka deklaruar burim krijimi para noterit publik “Dhuratë nga vëllai i gruas S. L.”.

**14.27** Subjekti është pyetur në lidhje me këtë burim të padeklaruar në secilën prej deklarimeve periodike dhe atë *Vetting*. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sërish deklaroi se burimi i të ardhurave për blerjen e apartamentit objekt verifikimi kanë qenë vetëm kursimet e tij dhe të bashkëshortes, duke theksuar se dhuratat e familjarëve ishin në kuadër të traditave familjare me rastin e martesës, pa tejkalar limitet e detyrimit për deklaram. Subjekti pretendoi se deklarimi

në burim gjatë hartimit të dokumentacionit ligjor për blerjen e kësaj pasurie është lapsus nga ana e noteres.

**14.28** Komisioni vlerësoi të verifikojë të gjitha burimet e të ardhurave të deklaruara nga subjekti, si vijon:

**a. Sa i takon burimit të të ardhurave të subjektit nga puna në shtetin italian**

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë ILDKPKI-së dhe përgjigjet e pyetësorit standard, rezultoi se subjekti ka paraqitur:

i) Fotokopje deklarate në gjuhën italiane të administratorit të shoqërisë “\*\*\*” srl, D. F., i cili deklaroi se: *“Shoqëria ka operuar në fushën e prodhimit të inertit për periudhën 1992 deri në dhjetor 2004, si partnere në jointventure “\*\*\*” sh.p.k. Z. Artur Cara ndodhej në Itali për motive personale në periudhën 1996, 1997, 1998. Shoqëria kishte nevojë për të kryer dërgesa materiale në ndryshme në Shqipëri, ndaj nevojitej një koordinator dhe ka përdorur përkohësisht shërbimet e ofruara të z. Artur Cara e për këtë i janë paguar: për vitin 1996 shuma 5.000.000 lireta; për vitin 1997 shuma 16.000.000 lireta, për vitin 1998 shuma 17.000.000 lireta”*.

ii) Fotokopje karte identiteti italiane, datë 2.6.1997 dhe të kartës së kodit fiskal të vitit 1995.

Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me qëndrimin dhe punësimin e tij në shtetin italian dhe, duke iu referuar deklaratës së lëshuar nga shtetasi D. F., të administruar edhe nga ILDKPKI-ja, deklaroi se për të ardhurat e tjera nuk disponon dokumentacion. Sa më sipër, nuk vërtetohen të ardhura të ligjshme të përfituara në Itali.

**b. Sa i takon të ardhurave të realizuara në Shqipëri nga pagat e subjektit**

Subjekti ka paraqitur vërtetime për të ardhurat nga paga si OPGJ, sipas të cilave të ardhurat për vitet 2000 – 2003 janë në vlerën 1.797.628,00 lekë.

**c. Sa i takon të ardhurave të bashkëshortes**

Të ardhurat e dokumentuara nga pagat e saj pranë shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., të përfituara nga viti 1995 deri në datën 31.12.2003, janë në vlerën 3.031.152 lekë.

Është kërkuar informacion për të ardhurat edhe nga ISSH, Drejtoria Rajonale e Arkivit Tiranë, ku vërtetohet se bashkëshortja e subjektit ka qenë e punësuar pranë kësaj shoqërie për periudhën shtator 1995 – mars 2004.

**Analiza financiare**

**14.29** Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e pagimit të shumës 38.000 USD deri në fund të vitit 2003, duke konsideruar të ardhurat dhe shpenzimet në momentin e kryerjes së pagesave, analizë nga e cila duket se ka rezultuar me balancë negative për periudhën 1995 – 2002, në vlerën -583.356 lekë dhe për periudhën 1.1.2003 – 19.6.2003 në vlerën -1.493.162 lekë.

**14.30** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën, nga sa duket se:

- Nuk provohet tërësisht me të ardhura të ligjshme pagimi i çmimit për blerjen e pasurisë në vlerën 38.000 USD, paguar deri në vitin 2003.

- Burimi i krijimit të pasurisë me kursime të akumuluar ndër vite bie në kundërshtim me deklaratimet gjatë hartimit të dokumentacionit ligjor, ku burim është deklaruar dhurimi.
- Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e vitit 2009 dhe në atë *Vetting* lidhur me burimet e krijimit të pasurisë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**14.31** Në parashtrimet e tij, subjekti pretendoi si vijon:

i) Në lidhje me objektin e kredisë së financuar nga Credins Bank me kontratën e kredisë bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.5.2010, subjekti theksoi se qëllimi i saj ka qenë arredimi i dhomës së fëmijëve në vitin 2010, por duke detajuar shpenzimet në vlerën 5.130 euro për arredim dhe vlerën 9.570 euro për sistemimet në banesë.

Në mbështetje të argumenteve të tij, ka depozituar komunikimin elektronik me Credins Bank në datën 12.7.2023, ku ka kërkuar shpjegime në lidhje me qëllimin e cilësuar në dokumentin bankar, në dosjen e kredisë së vitit 2010. Credins Bank ka sqaruar subjektin se: *“Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana juaj, paraqitur edhe në dokumente (kontratë kredie), qëllimi i kredisë ka qenë “blerje/investim në blerje apartamenti”. Në këtë periudhë kreditë hipotekore për qëllim blerje apo investim në apartament klasifikoheshin në të njëjtën fashë të kredive afatgjata housing. Duke qenë se dosja juaj e kredisë është mbyllur dhe arkivuar në dokumentet në përbërje të dosjes tuaj të kredisë, nuk ka asnjë kontratë/deklaratë huaje mes palësh të treta, ashtu sikurse edhe veprimi i tërheqjes cash, por edhe çdo dokument tjetër i plotësuar nga ju dhe dokumentuar në kontratë kredie, na bën të mendojmë që specifikimi në raport-analizë marrje huaje nga person i afërm mund të jetë mbartje ose lapsus i një punimi/analize të mëparshme që nuk ka të bëjë me rastin tuaj”*.

Subjekti sqaron: *“Nuk ka kuptim të kem kërkuar informacion nga Credins Bank për shlyerje detyrimesh për këtë apartament, ndërkohë që apartamenti ka qenë i regjistruar në ZVRPP në pronësinë time dhe personit të lidhur në atë kohë (viti 2003)”*. Në dokumentacionin e bankës pranohet se çmimi është paguar, por cilësohet se subjekti ka marrë një hua për të paguar një pjesë të çmimit.

ii) Lidhur me deklaratimet e noteres gjatë hartimit të dokumentacionit ligjor, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij ka rikujtuar: *“Në të njëjtën datë e njëjta notere ka bërë lapsusin me raportimin pasardhës lidhur me shtetasin P. Z. Noterja në këtë rast ka dhënë argumente në lidhje me vënien e emrit të bashkëshortes si palë në aktin noterial.*

*I vetmi shpjegim që unë prezumoj, është keqperceptim i bisedave/diskutimeve që mund të jenë bërë mes meje dhe bashkëshortes në zyrën e noteres për dhurata të vogla martesore, tradicionale për eventin e martesës, gjatë hartimit të kontratës së shitblerjes së apartamentit me sip. 120 m<sup>2</sup>. Edhe kjo nuk qëndron, pasi nëse noterja do të kishte lexuar me kujdes kontratën e porosisë dhe mandatpagesat bashkëlidhur kontratës, do të konstatonte se të gjitha pagesat për likuidimin e vlerës totale të apartamentit janë kryer nga unë dhe/apo bashkëshortja. Nuk qëndron si argument, pasi në këto akte nuk pasqyrohet burimi. Për këtë arsye, vihem në pozitë për një akt që nuk është përpiluar nga ana ime dhe më duhet të justifikoj deklaratimet e veprimet e dikujt tjetër”*.

Sipas subjektit, nëse do të kishte qenë një nga këto variante, pa dyshim do ishte deklaruar prej tij së paku në vitin 2009, në deklaratën përpara fillimit të detyrës, kohë kur nuk mendohej se do t'i nënshtrohej një hetimi të mirëfilltë administrativ.



Në parashtrimet e tij, subjekti lidhur me burimet e krijimit të pasurisë apartament me sip. 120 m<sup>2</sup> shpjegoi se si burim kanë shërbyer edhe kursimet nga puna e tij në Itali gjatë viteve 1995 – 1999.

iii) Me dokumentet e depozituara pranë Komisionit, subjekti paraqiti dokumentacion provues lidhur me punësimin e tij në Itali:

- kartë identiteti italiane, datë 2.6.1997;
- regjistrim në zyrën e punës, ku ka depozituar kartën e kodit fiskal.

Ai pretendoi për mundësi kursimi në vlerën 937.058 lekë për periudhën 1996 – 1998 me të ardhurat nga punësimi në Itali (duke konsideruar shpenzimet për konsum për këtë periudhë sipas statistikave të kohës), të cilat i ka përfshirë si të ardhura në analizën financiare të kryer prej tij për blerjen e apartamentit me sip. 120 m<sup>2</sup>.

Në parashtrimet e tij, subjekti sqaron se ai dhe bashkëshortja e tij janë martuar në maj të vitit 2005 dhe deri në këtë kohë kanë jetuar në regjim të përbashkët familjar. Prindërit u kanë dhënë mundësinë të akumulojnë pagat e tyre, me qëllim fillimin e një jete të re me martesën e tyre në maj të vitit 2005.

Subjekti sqaroi se bashkëshortja ka pasur të ardhura nga pagat e saj për periudhën 1995 – 2003 në shumën 3.031.152 lekë. Subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë personale datë 10.7.2023, të lëshuar nga prindërit e bashkëshortes<sup>1</sup>, të cilët deklarojnë se e bija ka jetuar në familjen e tyre deri në kurorëzimin në martesë në vitin 2005 dhe i kanë mbuluar të gjitha shpenzimet, duke mundësuar kursime nga paga e saj prej vitit 1995.

Sa i takon të ardhurave të realizuara në Shqipëri nga pagat e tij, subjekti ka paraqitur vërtetime për të ardhurat nga paga si OPGJ, sipas të cilave të ardhurat për vitet 2000 – 2003 janë në vlerën 1.797.628,00 lekë, duke pretenduar se pas shpenzimeve jetike ka mundur të kursejë shumën 1.221.770 lekë.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**14.32** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklarinimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

#### **Lidhur me saktësinë e deklarinimit**

**14.33** Nga vlerësimi i të gjithë situatës, fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ dhe shpjegimeve të subjektit në tërësi, trupi gjykues ka arritur në konkluzionin se nuk ka kushte për të krijuar dyshime për fshehjen e burimit të pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në arritjen e këtij konkluzioni trupi gjykues mbajti në konsideratë se nuk u provua asnjë veprim apo përpjekje e subjektit për të deformuar apo manipuluar të vërtetën në funksion të paraqitjes së rreme të të dhënave lidhur me pasurinë e tij.

<sup>1</sup> Shihni deklaratën personale datë 10.7.2023, të lëshuar nga shtetasit M. L. dhe L. L., në dosjen e Komisionit.

**14.34** Subjekti ka deklaruar në të njëjtën mënyrë, ndër vite, në vijimësi, se si burim krijimi për këtë pasuri kanë qenë kursime nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes dhe në asnjë moment nuk ka deklaruar se burim krijimi i kësaj pasurie është një dhuratë apo hua nga një person i paidentifikuar.

**14.35** Për sa më sipër, pasaktësitë e rezultuara në dokumentacionin ligjor për përfitimin e pasurisë së paluajtshme objekt deklarimi në deklaratën *Vetting*, ato nuk kanë afektuar deklarimin e kësaj pasurie të paluajtshme në deklaratën *Vetting* të vitit 2017.

**14.36** Parashikimet e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u analizuan duke i parë ngushtë me parashikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, nuk rezultuan të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave lidhur me këtë pasuri të paluajtshme.

**14.37** Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat e konstatuara lidhur me dokumentacionin ligjor nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe nuk kanë afektuar deklarimin e kësaj pasurie të paluajtshme në deklaratën *Vetting* të vitit 2017.

#### **Lidhur me mundësinë financiare**

**14.38** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton se:

- Për sa i përket të ardhurave të subjektit nga emigracioni, pavarësisht se vërtetohet fakti që ka qenë i punësuar në Itali, në kushtet kur as në të dhënat e deklaruara pranë ILDKPKI-së dhe as gjatë procesit, subjekti nuk ka arritur të paraqesë dokumente ligjore provuese, që të vërtetojnë sasinë e të ardhurave të përfituara dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to, si dhe për sa në DPV-në e vitit 2009, kur është deklaruar pasuria, nuk janë përmendur të ardhura nga emigracioni dhe në DPV-në e vitit 2004/2005 si OPGJ nuk janë deklaruar likuiditete *cash* me burim të ardhura nga emigracioni sipas parashikimeve ligjore, të ardhurat e subjektit nga emigracioni në vitet 1996 – 1998 nuk merren në konsideratë në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie.

**14.39** Trupi gjykues, lidhur me mbulimin nga familja e bashkëshortes deri në vitin 2005 të shpenzimeve të jetesës së saj para se të lidhnin martesën ligjore, ka vlerësuar se për sa bashkëshortja nuk ka qenë në një certifikatë familjare me subjektin dhe nuk ka plotësuar deklarime periodike si person i lidhur, ky pretendim duhet të merret në konsideratë në analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie lidhur me mbulimin e shpenzimeve jetike të bashkëshortes nga familjarët e saj para martesës me subjektin.

Pas reflektimit të sa më sipër arsyetuar, analiza financiare rezultoi si vijon:

<b>Blerje apartamenti, paguar deri më 19.6.2003</b>	<b>Analiza financiare me rezultatet e hetimit për periudhën 1995 – 19.6.2003</b>	<b>Analiza financiare pas kalimit të barrës së provës për periudhën 1995 – 19.6.2003</b>
<b>Pasuri</b>	<b>5 066 057</b>	<b>5 066 057</b>
Apartament me sip. 120 m <sup>2</sup> , Tiranë	<b>5 066 057</b>	<b>5 066 057</b>
<b>Të ardhura dokumentuar</b>	<b>4 357 106</b>	<b>4 357 106</b>
Të ardhura nga paga e subjektit (2000 – 2003)	1 542 300	1 542 300
Të ardhura nga paga e bashkëshortes (1995 – 2003)	2 814 806	2 814 806
<b>Shpenzime</b>	<b>1 366 966</b>	<b>-504 876</b>
Shpenzime jetese subjekti + bashkëshortja	1 219 566	356 876
Shpenzime udhëtimi (punësimi jashtë adresës së banimit)	148 000	148 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-2 076 518</b>	<b>-1 213 828</b>

**14.40** Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, duke rezultuar me një balancë negative deri në datën 19.6.2003, në vlerën -1.213.828 lekë.

**14.41** Trupi gjykues vlerëson se mungesa e likuiditetit deri në datën 19.6.2003, në vlerën -1.213.828 lekë për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme, para se subjekti i rivlerësimit të emërohej në detyrën e prokurorit, duke marrë në konsideratë edhe parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

### **15. Apartament me sip. 72.9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sarandë, në vlerën 16.000 euro**

Sipas kontratës së shitjes në të ardhmen nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.2.2012, vlerë e likuiduar në vitin 2012 palës shitëse I. S.. Apartament i paregjistruar në ZVRPP. Burimi i krijimit: “*Të ardhurat gjendje të krijuara nga puna ime dhe e bashkëshortes prej vitit 1995 në Itali dhe në Shqipëri. Gjendje edhe nga kredia sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 17.5.2010 pranë Credins Bank, në vlerën 15.000 euro. Vlera: 16.000 euro. Pjesa takuese: 50%*”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

**15.1** Me kontratë shitjeje të sendit në të ardhmen nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.2.2012, shtetasi I. S. i shet shtetasit Artur Cara një apartament me sip. 72.9 m<sup>2</sup> në Sarandë, në çmimin 16.000 euro.

**15.2** Në DPV-në e vitit 2012 subjekti e ka deklaruar këtë pasuri me këto të dhëna si pasuri të paregjistruar.

**15.3** FSHU-ja<sup>2</sup> ka konfirmuar se abonentit Artur B. Cara ka kontratë furnizimi nr. \*\*\* në instancën Sarandë. Nga detajet e formularit të abonentit rezulton kontratë provizore e lidhur në datën 10.11.2014. Në muajt nëntor - dhjetor 2014 ka konsum energjie, në vijim vërehet konsum i energjisë gjatë periudhës pranverë - verë.

<sup>2</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2023, të FSHU-së, në dosjen e Komisionit.

**15.4** Me kërkesë të Komisionit, noterja S. X. paraqiti kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.2.2012, si dhe faqen e regjistrimit noterial ku është regjistruar ky akt. Në përmbajtje të kontratës përcaktohet se:

i) Pala shitëse është pronare e një trualli me sip. 600 m<sup>2</sup>, e regjistruar në ZVRPP-në Sarandë, mbi të cilin është ndërtuar një objekt banimi 5-katësh, sipas përcaktimit të bërë në lejen e ndërtimit nr. \*\*\*, datë 17.11.2006 dhe sheshit të ndërtimit nr. \*\*\*, datë 17.11.2006, lëshuar nga KRRT-ja Sarandë.

ii) Pala blerëse do të blejë apartamentin të papërfunduar dhe pa rifinitura të brendshme (pa shtrim me pllaka, pa dritare dhe dyer, pa pajisje hidrosanitare, punime të cilat do të kryhen totalisht nga blerësi me shpenzimet e veta.

iii) Sa i takon çmimit, është parashikuar se vlera e shitjes do të jetë 220 euro/m<sup>2</sup>, gjithsej 16.000 euro, shumë e cila do të likuidohet me këste brenda vitit 2013. Pala blerëse deri në këtë moment ka likuiduar këstin prej 10.000 euro. Me likuidimin e vlerës 16.000 euro dhe përfundimin e të gjitha punimeve të brendshme nga pala blerëse, palët do të realizojnë kontratën përfundimtare.

iv) Blerësi ka të drejtë të marrë në dorëzim apartamentin vetëm me përfundimin e plotë të punimeve, lidhjes së kontratës përfundimtare për kalimin e pronësisë, likuidimin e detyrimeve ndaj investitorit, KESH dhe Ujësjellës. Bashkëlidhur me kontratën ndodhet planimetria e katit të tretë.

**15.5** Sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., datë 16.5.2012, deklaruesit I. S. dhe Artur Cara deklarojnë *“Likuidimin e këstit të dytë në shumën 6.000 euro, sot, cash në dorë, jashtë zyrës noteriale”*. Sipas kësaj deklarate, pala shitëse në momentin që do të pajiset me certifikatë pronësie do të realizojë kontratën përfundimtare me palën blerëse.

**15.6** Noterja S. X., me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.5.2023, vuri në dispozicion deklaratën noteriale të ndodhur në arkivin e saj dhe fletë të regjistrimit noterial ku është regjistruar ky akt.

#### **Në lidhje me çmimin e paguar për blerjen e pasurisë në vlerën 16.000 euro**

**15.7** Apartamenti është dakordësuar për t'u blerë i papërfunduar, pa u bërë rifiniturat e brendshme (pa u shtruar me pllaka, pa u vendosur dritare, dyer dhe pajisjet hidrosanitare). Çmimi i blerjes së apartamentit me sip. 72.9 m<sup>2</sup> është vendosur nga palët 220 euro/m<sup>2</sup> (30.727 lekë/m<sup>2</sup>)<sup>3</sup>.

**15.8** Sipas udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, të Entit Kombëtar të Banesave, në fuqi për vitin 2012, vlera mesatare e shitblerjeve në tregun e lirë për qytetin e Sarandës ka qenë 52.096,00 lekë/m<sup>2</sup>.

**15.9** Duke konsideruar që apartamenti është dakordësuar për t'u blerë i papërfunduar, pa u bërë rifiniturat e brendshme (pa u shtruar me pllaka, pa u vendosur dritare, dyer dhe pajisjet hidrosanitare), çmimi i blerjes së apartamentit me sip. 72.9 m<sup>2</sup> është vendosur nga palët 220 euro/m<sup>2</sup> (30.727 lekë/m<sup>2</sup>)<sup>4</sup>, çmim i cili është afër kostos mesatare për sipërfaqe të ndërtimit 30.306 lekë/m<sup>2</sup> dhe më i vogël se kostoja mesatare e ndërtimit për sipërfaqe shfrytëzimi prej 36.904 lekë/m<sup>2</sup> në këtë qytet, sipas udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, të EKB-së.

**15.10** Subjektit iu kërkua të paraqesë kontrata të ngjashme, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 3 paraqiti: (i) fotokopje kontratë shitjeje me rezervë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.8.2010, e

<sup>3</sup> Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën 23.2.2012, euro/lekë = 139.67

<sup>4</sup> Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën 23.2.2012, euro/lekë = 139.67

lidhur mes shtetasve I. S. dhe M. E., S. Sh. për shitjen e një apartamenti prej 74.8 m<sup>2</sup> në vlerën 31.500 euro, i cili do të jetë i përfunduar; (ii) fotokopje kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, nr. \*\*\* kol., datë 26.12.2014, mes shtetasve I. S. dhe A. B. për një apartament banimi me sip. 39 m<sup>2</sup> me sipërfaqe totale prej 52 m<sup>2</sup>. Vlera totale e kontratës 2.000.000 lekë, e cila i është dhënë totalisht porositësit që prej vitit 2013. Kalimi i pronësisë do të bëhet pas regjistrimit të ndërtesës në ZVRPP. Në këtë kontratë përcaktohet se investitori ka kryer përfundimin e banesës + lokaleve dhe se ka kryer edhe dorëzimin e apartamentit tek pala kontrataktore; (iii) fotokopje kontratë shitjeje me rezervë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë (*nuk lexohet*), janar 2011, mes shtetasve I. S. dhe N. V., për një apartament me sip. 46 m<sup>2</sup>, në vlerën 23.000 euro, i cili do të jetë i përfunduar plotësisht.

*Pas verifikimeve nuk rezultuan të dhëna për trajtim preferencial apo konflikt interesi lidhur me këtë pasuri.*

### **Në lidhje me burimin e krijimit, rezulton se:**

- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat gjendje të krijuara nga puna e tij dhe e bashkëshortes prej vitit 1995 në Itali dhe në Shqipëri, si dhe gjendjen nga kredia sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 17.5.2010, të Credins Bank, në vlerën 15.000 euro.
- Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar si burim krijimi kursime të familjes.

### **Analiza e burimeve të krijimit**

**15.11** Shuma 16.000 euro është paguar në këtë mënyrë: 10.000 euro në datën 23.2.2012, me lidhjen e kontratës paraprake; 6.000 euro në datën 16.5.2012, sipas deklaratës noteriale me këtë datë.

#### **a. Sa i takon kursimeve të familjes**

Në DPFD-në e vitit 2009, me funksion prokuror nga data 10.12.2009, subjekti ka deklaruar: *“Vlera monetare cash e akumuluar në vite. Vlera: 1.600.000 lekë. Pjesa takuese: 50%”*.

Në deklaratimet e mëpasshme vjetore, subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*, ndërsa në deklarinimin e vitit 2012 ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* për pagimin e këtij apartamenti.

Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e gjendjes së likuiditetit *cash* prej 1.600.000 lekësh, përdorur si burim për sa vijon:

- Në DPV-të e viteve 2003 dhe 2004, me funksion OPGJ, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete. Komisioni, për këtë arsye, me rezultatet e hetimit ka kryer analizën financiare, duke përdorur metodologjinë kumulative për krijimin e gjendjes *cash* prej 1.600.000 lekësh, deklaruar në DPFD-në e vitit 2009 për periudhën 2005 – 10.12.2009, në të cilën janë përfshirë: (i) të ardhurat e dokumentuara për periudhën 1.1.2005 – 10.12.2009 të subjektit dhe të bashkëshortes<sup>5</sup>; (ii) shpenzimet e mobilimit dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së; (iii) likuiditetet në sistemin bankar në emër të subjektit dhe personit të lidhur.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 2005 – 10.12.2009</b>
<b>PASURI</b>	<b>1 987 964</b>
Automjet tip “Opel Zafira”, blerë në vitin 2005, sipas deklarimeve në DPFD-në e vitit 2009 (jo e dokumentuar)	796 510
Shtesa/pakësime likuiditetesh	<b>1 191 454</b>

<sup>5</sup> Lidhur martesë në datën 23.5.2005, por sipas deklarinimit të subjektit në pyetësorin standard bashkëjetonin që prej vitit 2004.

Gjendja e likuiditeteve ( <i>cash</i> + bankë)	<b>1 596 265</b>
<b>TË ARDHURA</b>	<b>4 985 522</b>
Të ardhura nga paga subjekti	2 959 198
Të ardhura nga paga bashkëshortja	1 794 964
Të ardhura nga kredia konsumatore RFZ subjekti, 57 500 lekë	57 500
Të ardhura nga kredia konsumatore RFZ subjekti, 49 200 lekë	49 200
Të ardhura nga kredia RFZ bashkëshortja, 110 000 lekë	110 000
Të ardhura nga depozita me afat/interesa bankarë	14 660
<b>SHPENZIME</b>	<b>3 308 280</b>
Shpenzime jetese	2 067 683
Pagesa kredia konsumatore RFZ subjekti, 57 500 lekë	63 943
Pagesa kredia konsumatore RFZ subjekti, 49 200 lekë	16 567
Pagesa kredia konsumatore RFZ bashkëshortja, 110 000 lekë	63 020
Shpenzime udhëtimi (punësimi jashtë adresës së banimit)	112 000
Shpenzime udhëtimi TIMS	318 368
Shpenzime komisione kredie (RFZ)	16 000
Shpenzime për mobilimin e apartamentit 120 m <sup>2</sup> (30% e totalit)	450 000
Shpenzuar për blerje pajisjesh elektronike (kreditë RFZ 2008 – 2009)	200 700
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-310 722</b>

Nga kjo analizë e rezultateve të hetimit ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e të gjithë gjendjes *cash* prej 1.600.000 lekësh, deklaruar në vitin 2009, për shkak të një balance negative prej 310.722 lekësh. Bazuar në sa më sipër, nga gjendja *cash* 1.600.000 lekë e deklaruar nga subjekti me rezultatet e hetimit është konsideruar vetëm shuma 1.289.278 lekë si e provuar nga hetimi.

#### **b. Sa i takon burimit 15.000 euro nga kredia në Credins Bank, me kontratë datë 17.5.2010**

Kredia e marrë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 17.5.2010, pranë Credins Bank, në vlerën 15.000 euro, është deklaruar si burim për herë të parë në deklaratën *Vetting*.

I pyetur për këtë fakt, në përgjigje të pyetëtorit nr. 2, subjekti sqaroi se deklarimi i kredisë në deklaratën *Vetting* ka qenë një lapsus nga ana e tij, pasi ashtu siç është konstatuar nga Komisioni kredia e vitit 2010 nuk mund të jetë përdorur për likuidimin e vlerës së apartamentit në kushtet kur dy këstet janë paguar në datat 23.2.2012 dhe 16.5.2012.

Me qëllim vërtetimin e këtij deklarimi, Komisioni evidentoi se:

- Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar kredi në shumën 15.000 euro në Credins Bank, me kontratë datë 17.5.2010, duke e deklaruar *për shlyerje detyrimi për apartamentin ku banon në \*\*\** (trajtuar më sipër).

- Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në vitin 2016, ka shpjeguar se kjo kredi ka shërbyer për arredimin e shtëpisë në \*\*\*.

Pra, kredia nuk mund të këtë shërbyer për blerjen e pasurisë objekt verifikimi në vitin 2012 dhe se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë përdorimin e kredisë për blerjen e pasurisë në deklaratën *Vetting*, sikurse e ka pranuar edhe vetë në përgjigje të pyetëtorit nr. 2.

#### **Analiza financiare për blerjen e apartamentit**

**15.12** Në analizën financiare të kryer është pasqyruar mundësia financiare për pagimin e shumës 10.000 euro në datën 23.2.2012, si dhe pagimin e shumës 6.000 euro në datën 16.5.2012, duke konsideruar si të ardhur likuiditetin *cash* në vlerën 1.289.278 lekë.

Përshkrimi	23.2.2012	16.5.2012
<b>PASURI</b>	<b>112 831</b>	<b>852,492</b>
Apartament me sip. 79 m <sup>2</sup> , Sarandë	1,396,700	833,700
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>-1 283 869</i>	<i>18,792</i>
Gjendja e likuiditeteve	37,691	56,483
<b>TË ARDHURA</b>	<b>198,926</b>	<b>486,279</b>
Të ardhura nga paga subjekti	163,466	379,899
Të ardhura nga paga bashkëshortja	35,460	106,380
<b>SHPENZIME</b>	<b>298,148</b>	<b>188,967</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	93,032	116290
Shpenzime për shkollimin e vajzës	139,670	
Pagesa principal + interes kredie Credins Bank (Eur 15,000/2010)	44,834	43,380
Pagesa principal + interesi kredie RFZ (Lek 49,200/2008 – 2012)	3,012	4,518
Shpenzime kredie Eur 15,000 (sig. prone) & komisione bankare		2,779
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	17,600	22,000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-212 053</b>	<b>-555,180</b>

**15.13** Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur mundësi të investojnë në blerjen e apartamentit, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare, pasi mundësia për kursime deri në shlyerjen e çmimit të apartamentit rezultoi me balancë negative 212.053 lekë në datën e pagesës së kështit të parë, 23.2.2012 dhe 555.180 lekë në datën e pagesës së kështit të dytë, 16.5.2012.

**15.14** Në lidhje me shpenzimin e shkollimit të vajzës K. C., sipas vërtetimit nr. \*\*\*, datë 30.6.2020, të shkollës “\*\*\*”, është kryer një pagesë prej 1.000 euro për vitin 2012. Në pyetësorin nr. 3 është pyetur subjekti në lidhje me periudhën kur është paguar kjo shumë, por nuk ka dhënë informacion. Për këtë arsye shpenzimi prej 1.000 euro është konsideruar si i kryer në janar të vitit 2012.

### **Sa i takon shpenzimeve për përfundimin e punimeve shtesë të apartamentit**

**15.15** Nga hetimi administrativ rezultoi se:

- Në kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.2.2012, parashikohet se pala blerëse do ta blejë apartamentin të papërfunduar dhe pa rifinitura të brendshme (pa shtrim me pllaka, pa dritare dhe dyer, pa pajisje hidrosanitare, punime të cilat do të kryhen totalisht nga blerësi me shpenzimet e veta), që do të thotë se me këtë kontratë është blerë apartamenti në gjendje karabinaje.

- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar vetëm vlerën e blerjes së pasurisë në gjendje karabinaje, pra nuk ka deklaruar vlerën reale të pasurisë dhe, për rrjedhojë, burimin e krijimit të punimeve shtesë. Edhe në DPV-të e viteve 2013 – 2016, ashtu sikurse në deklaratën *Vetting*, nuk janë kryer deklarime në lidhje me punimet shtesë, vlerën dhe burimet.

- Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Kredi e re, disbursuar në datën 21.12.2016, në vlerën 21.000 euro. Qëllim i shtimit të vlerës së kredisë është shlyerje e detyrimeve të rregullimeve dhe mobilimit shtëpiak, si dhe blerje të automjetit (veprime të kryera në vitin pasardhës 2017)*”. Sipas kontratës së kredisë me Credins Bank, subjekti ka marrë një kredi në shumën 21.000 euro, e cila është disbursuar në datën 21.12.2016. Kjo kredi është deklaruar si detyrim financiar edhe në deklaratën *Vetting*, marrë me qëllim shlyerjen e detyrimeve të rregullimeve dhe mobilimit të banesës, si dhe blerjen e automjetit. Sipas kontratës së kredisë

nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.12.2016, subjekti dhe bashkëshortja janë financuar me një kredi prej 21.000 euro, me afat 15-vjeçar, me objekt kreditimi “Mobilim dhe shlyerje detyrimi” (detyrimi ndaj shtetasit F. V., trajtuar hollësisht në rubrikën “Detyrime financiare”).

- Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar *shpenzime për të mbyllur punimet e bojatisjes, shtrimit me pllaka, hidrosanitare dhe dyer të brendshme, në shumën rreth 300.000-320.000 lekë. Detyrimet janë likuiduar me kredinë e vitit 2016, përfshirë edhe pjesë të mobilimit të domosdoshëm. Në vazhdimësi janë blerë pajisje të nevojshme për apartamentin.*

- Gjatë procesit subjektit iu kërkua të përcaktojë kohën e saktë të shpenzimeve të kryera për përfundimin e punimeve, si dhe kohën e saktë të shlyerjes së detyrimeve dhe ndaj kujt subjekt kanë qenë detyrimet, i cili përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se *shpenzimet janë kryer gjatë viteve 2013 – 2016, punime të cilat janë kryer nga teknikë të angazhuar nga personi fizik “B. A.” dhe se këto shërbime janë paguar cash referuar çmimeve të tregut të atëhershëm.* Sa i takon dokumentacionit, subjekti deklaroi se nuk i disponon aktualisht faturat, por i është drejtuar personit fizik për të mundësuar dokumentacion, nëse e disponon.

- Sa i takon deklaratimit të subjektit se punimet janë kryer nga personi fizik “B. A.”, Komisioni verifikoi në sistemin e QKB-së, nga ku rezultoi vetëm një subjekt me emër B. A. Sipas ekstraktit historik ky subjekt rezultoi i regjistruar në datën 11.8.2021, me \*\*\*, me fushë veprimtarie punime-ndërtime në Sarandë, i cili në datën 1.11.2022 ka kaluar me status të pezulluar. Siç vërehet, personi fizik “B. A.” nuk ka qenë i regjistruar si person fizik në kohën e kryerjeve të punimeve për periudhën para vitit 2021, ndërkohë që deklarimet e subjektit të rivlerësimit për shlyerje të detyrimeve ndaj këtij subjekti me kredinë e marrë në vitin 2016, janë në nivel deklarativ.

**15.16** Siç vërehet, subjekti, në DPV-në e vitit 2016, në pyetësorin standard dhe gjatë procesit, ka kryer deklarime që bëjnë fjalë për detyrime financiare, për shkak të përfundimit të punimeve të apartamentit dhe mobilimit të tij. Por, në DPV-të e viteve 2013, 2014 dhe 2015 nuk rezultoi që të këtë deklaruar detyrime financiare ndaj ndonjë subjekti.

**15.17** Sa më sipër, në kushtet kur: (i) subjekti nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj ndonjë subjekti; (ii) referuar deklarimeve në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ku ka deklaruar se këto shërbime (për përfundimin e punimeve) janë paguar *cash* referuar çmimeve të tregut të atëhershëm – kredia e marrë në vitin 2016 nuk është konsideruar si burim për përfundimin e punimeve. Për më tepër, nga aktet rezultoi se kredia e marrë në vitin 2016 është përdorur në këtë mënyrë: (i) vlera 10.675 euro është transferuar në llogarinë me përfitues F. V., në datën 22.12.2016; (ii) vlera 5.700 euro është transferuar në llogarinë me përfituese S. B. , në datën 23.1.2017; (iii) ndërsa shuma 4.745 euro është tërhequr *cash* nga subjekti në datën 30.1.2017, në deklaratën e të cilit ai nuk ka kryer deklarime për shlyerje detyrimesh financiare dhe as shpenzime me burim kredinë mbi 300.000 lekë, sikurse ligji e kërkon.

### **Analiza financiare për investimet e kryera për përfundimin e punimeve**

**15.18** Përpara kryerjes së analizës financiare është bërë i domosdoshëm përcaktimi i vlerës së punimeve shtesë, si dhe periudhës së kryerjes së shpenzimeve. Sa i takon vlerës së punimeve dhe periudhës, deklarimet e subjektit që shpenzimet në vlerën 300.000 - 320.000 lekë i përkasin periudhës 2013 – 2016 janë në nivel deklarativ. Gjithashtu, nuk rezultoi që në deklaratat e këtyre viteve subjekti të ketë kryer deklarime në lidhje me vlerën e investimit dhe periudhat përkatëse. Në këto kushte, si periudhë e investimeve për përfundimin e punimeve është



konsideruar periudha që nga data 16.5.2012, kur është likuiduar vlera 6.000 euro për blerjen e karabinasë, deri më 31.10.2014, kur sipas të dhënave të FSHU-së në muajin nëntor 2014 është lidhur kontrata e energjisë elektrike, fakt që tregon se apartamenti ka nisur të përdoret.

**15.19** Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasurinë objekt verifikimi, apartament me sip.72.9 m<sup>2</sup> në Sarandë, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve, ku duket se:

- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* vlerën e saktë të pasurisë, pasi ka deklaruar vetëm vlerën e karabinasë prej 16.000 euro dhe burimin e saj. Po kështu, ka pasaktësi në deklarin e burimit, pasi është shtuar gjendje nga kredia e marrë në datën 17.5.2010, në shumën 15.000 euro.

- Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur mundësi në periudhën 1.1.2012 – 16.5.2012 për pagimin e shumës 10.000 euro në datën 23.2.2012 dhe shumës 6.000 euro në datën 16.5.2012, pasi rezulton me balancë negative, në total 767.234 lekë.

- Subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur mundësi financiare për përfundimin e punimeve për shkak të një balance negative prej 269.793 lekësh në vitin 2013 dhe 478.904 lekësh në vitin 2014.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**15.20** Për sa i përket deklaramit në deklaratën *Vetting* të vlerës prej 16.000 euro të pasurisë objekt verifikimi, sqaron se është bërë sipas përcaktimeve në kontratë shitjeje të sendit në të ardhmen me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.2.2012. Sipas subjektit, në këtë kontratë parashikohet shprehimisht se palët kanë rënë dakord që pala blerëse ta blejë këtë apartament të papërfunduar, pa u bërë rifiniturat e brendshme në objekt (pa u shtruar apartamenti me pllaka, pa u vendosur dritaret e dyert, pa u vendosur pajisjet hidrosanitare, punime të cilat do të kryhen totalisht nga pala blerëse me shpenzimet e veta). Sipas subjektit nuk bëhet fjalë për objekt në gjendje karabinaje, por objekt i përfunduar, për të cilin palët kanë rënë në marrëveshje që të përzgjidhen në raport me shijet personale pllakat, hidrosanitaret, materialet e dritareve dhe të dyerve të brendshme. Sipas tij, sipërfaqja e banueshme e apartamentit është 65.8 m<sup>2</sup> dhe investimi i kryer në të ka qenë modest, për shkak të koeficientit të ulët të shfrytëzimit nga ana e tyre, vetëm një muaj në vit.

**15.21** Për sa i përket pasaktësisë në deklarin e burimit, pasi është shtuar gjendje nga kredia e marrë në datën 17.5.2010, në shumën 15.000 euro, subjekti vijon të deklarojë, sikurse edhe gjatë procesit, duke kërkuar sërish që Komisioni ta konsiderojë lapsus këtë deklarin të tij.

**15.22** Për sa i përket mundësisë për kursime për blerjen e apartamentit, në parashtrimet e tij, subjekti kundërshton rezultatin e analizës financiare të kryer nga Komisioni, duke paraqitur analizën financiare të kryer nga ana e tij për periudhën 1.1.2005 – 9.12.2009, për krijimin e gjendjes *cash* prej 1.600.000 lekësh, të deklaruar në DPDFD-në e vitit 2009.

**15.23** Për sa i përket përlllogaritjes së kryer nga ana e Komisionit të vlerës së punimeve për përfundimin e objektit, subjekti kundërshton vlerat e përfshira në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**15.24** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe

provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton se:

- Sa i takon deklaratimit të pasaktë të vlerës së pasurisë në deklaratën *Vetting*, subjekti shpjegoi bindshëm se vlera 16.000 euro e deklaruar prej tij konsiderohet vlera e blerjes në vitin 2012 sipas dokumentit ligjor faktik të kohës të hartuar mes palëve dhe duke qenë se investimi për të përfunduar punimet e plota konsiderohen si shpenzime gjatë viteve, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të saktë në deklaratën *Vetting* lidhur me vlerën e pasurisë.

**15.25** Trupi gjykues, pas analizimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, konsideroi se subjekti arriti të provojë mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në vlerën e deklaruar prej 1.600.000 lekësh para fillimit të detyrës dhe vlera 1.289.278 lekë e llogaritur nga Komisioni u rishikua në analizë financiare, pasi:

- Subjekti shpjegoi bindshëm lidhur me shpenzimet e mobilimit për apartamentin me sip. 120 m<sup>2</sup> prej 1.500.000 lekësh dhe rishpërndarjen e tyre në vite. Në analizën financiare, trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e subjektit për shpenzimet e mobilimit të këtij apartamenti (pa shpenzimet për elektroshtëpiaket e blera me kredi në shumën 200.700 lekë) që do të jetë në shumën 598.132 lekë, e cila është konsideruar e shpenzuar dhe paraqitur në analizën financiare të kësaj periudhe, si vijon: (i) 100.000 lekë në vitin 2003, meqenëse subjekti në parashtrimet e tij e deklaroi të shpenzuar si parapagim në këtë vit; (ii) 60% ose 298.879 lekë në vitin 2004; (iii) 40% ose 199.253 lekë në vitin 2005, kur subjekti është martuar.

**15.26** Pra, në analizën financiare të periudhës 2005 – 10.12.2009 shpenzimet e mobilimit të apartamentit u konsideruan në shumën 199.253 lekë.

- Shpenzime të disa udhëtimeve të subjektit dhe familjarëve jashtë vendit, më konkretisht shpenzim i një udhëtimi në Kanada i subjektit dhe familjes së tij në vitin 2008, ku subjekti provoi se biletat e udhëtimit janë paguar nga motra e bashkëshortes dhe, për sa më sipër arsyetuar, shpenzimet e udhëtimit u rillogaritën nga vlera 318.368 në vlerën 163.447 lekë, për periudhën 2005 – 10.12.2009.

- Shpenzimet jetike para martesës së subjektit me bashkëshorten, duke konsideruar vetëm shpenzimet jetike të subjektit deri në datën e martesës 23.5.2005 dhe më pas sipas përbërjes familjare. Shpenzime jetike për sa më sipër arsyetuar u rillogaritën për periudhën 2005 – 10.12.2009 nga vlera 2.067.683 në vlerën 1.976.385 lekë.

- U korigjuan shpenzimet e udhëtimit për vendin e punës për vitin 2005, pasi subjekti provoi se nga muaji tetor ka qenë i komanduar në Tiranë. Shpenzimi për këtë zë të analizës financiare për periudhën 2005 – 10.12.2009 u rillogarit nga vlera 112.000 në vlerën 33.000 lekë.

	<b>Periudha 2005 – 10.12.2009, rezultate të hetimit administrativ</b>	<b>Periudha 2005 – 10.12.2009 pas kalimit të barrës së provës</b>
<b>PASURI</b>	<b>1 987 964</b>	<b>1 987 964</b>
Automjet tip “Opel Zafira”, blerë në vitin 2005, sipas deklarimeve në DPPD-në e vitit 2009 (jo e dokumentuar)	796 510	796 510
<i>Shtesa/pakësime likuiditetesh</i>	<i>1 191 454</i>	<i>1 191 454</i>
Gjendja e likuiditeteve ( <i>cash</i> + bankë)	<b>1 596 265</b>	<b>1 596 265</b>

<b>TË ARDHURA</b>	<b>4 985 522</b>	<b>4 985 522</b>
Të ardhura nga paga subjekti	2 959 198	2 959 198
Të ardhura nga paga bashkëshortja	1 794 964	1 794 964
Të ardhura nga kredia konsumatore RFZ subjekti, 57 500 lekë	57 500	57 500
Të ardhura nga kredia konsumatore RFZ subjekti, 49 200 lekë	49 200	49 200
Të ardhura nga kredia RFZ bashkëshortja, 110 000 lekë	110 000	110 000
Të ardhura nga depozita me afat/interesa bankarë	14 660	14 660
<b>SHPENZIME</b>	<b>3 308 280</b>	<b>2 735 315</b>
Shpenzime jetese	2 067 683	1 976 385
Pagesa kredia konsumatore RFZ subjekti, 57 500 lekë	63 943	63 943
Pagesa kredia konsumatore RFZ subjekti 49 200 lekë	16 567	16 567
Pagesa kredia konsumatore RFZ bashkëshortja 110 000 lekë	63 020	63 020
Shpenzime udhëtimi (punësimi jashtë adresës së banimit)	112 000	33 000
Shpenzime udhëtimi TIMS	318 368	163 447
Shpenzime komisione kredie (RFZ)	16 000	16 000
Shpenzime për mobilimin e apartamentit 120 m <sup>2</sup> (30% të totalit)	450 000	199 253
Shpenzuar për blerje pajisjesh elektronike (kreditë RFZ 2008 – 2009)	200 700	200 700
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-310 722</b>	<b>265 243</b>

**15.27** Si rrjedhojë e reflektimit në analizën financiare të pretendimeve të subjektit pas kalimit të barrës së provës, provuar e shpjeguar bindshëm prej tij, analiza financiare për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në shumën 1.600.000 lekë, përdorur si burim për blerjen e apartamentit nga balanca negative prej -310.722 lekësh, rezultoi me një balancë pozitive prej 265.243 lekësh. Si rrjedhojë e këtij ndryshimi, në analizën financiare shuma prej 1.600.000 lekësh gjendje *cash* u konsiderua në vlerën e plotë si burim për blerjen e apartamentit në Sarandë nga vlera 1.289.278 lekë e cila ishte llogaritur si gjendje *cash* me rezultatet e hetimit administrativ.

**15.28** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit lidhur me sa më sipër, gjendjen *cash* dhe reflektoi si të provuar përdorimin e gjendjes *cash* në shumën 1.600.000 lekë, analizoi edhe shpjegimet e subjektit mbi analizën financiare për blerjen e apartamentit në Sarandë në shumën 10.000 euro në datën 23.2.2012 dhe në shumën 6.000 euro në datën 16.5.2012, duke konsideruar dhe reflektuar në analizë pretendimet e subjektit mbi kohën e pagimit të shpenzimeve për shkollimin e vajzës si të kryer në fillim të vitit shkollor.

**15.29** Në përfundim, mundësia për kursim dhe pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit në Sarandë në vitin 2012, rezultati negativ reduktohet nga -767.234 lekë në -316.842 lekë.

**15.30** Për sa i përket shpenzimeve për rikonstruksionin e këtij apartamenti, nga çmimi i referencës së marrë nga udhëzimi i EKB-së prej 3.228.128 lekësh, duke zbritur vlerën e paguar 16.000 lekë, kostoja e mbetur prej 997.728 lekësh, e shpërndarë në 28.5 muaj për periudhën 16.5.2012 – 31.10.2014, do të rezultonte me një analizë përfundimtare financiare për subjektin e rivlerësimit dhe për personin e lidhur me pamundësi financiare, në total -312.287 lekë.

	<b>Analiza financiare me rezultatet e hetimit</b>	<b>Analiza financiare pas kalimit të barrës së provës</b>
--	---	---

	2013	1.1.2014 – 31.10.2014	2013	1.1.2014 – 31.10.2014
<b>PASURI</b>	<b>54,455</b>	<b>30,392</b>	<b>54,455</b>	<b>30,392</b>
<i>Shtesa/pakësime likuiditetesh</i>	<i>54,455</i>	<i>30,392</i>	<i>54,455</i>	<i>30,392</i>
Gjendja e likuiditeteve	72,792	103,184	72,792	103,184
<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,650,192</b>	<b>1,557,363</b>	<b>1,650,192</b>	<b>1,557,363</b>
Të ardhura nga paga subjekti	1,303,052	1,249,383	1,303,052	1,249,383
Të ardhura nga paga bashkëshortja	347,140	307,980	347,140	307,980
<b>SHPENZIME</b>	<b>1,865,531</b>	<b>2,005,875</b>		
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	564,096	733,327	564,096	733,327
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve	280,420	280,220	280,420	280,220
Pagesa të kredisë (principal + interes) Credins Bank (Eur 15,000/2010)	259,346	202,242	259,346	202,242
Shpenzime kredie Eur 15,000 (sig. jete)	5,048	4,764	5,048	4,764
Shpenzime llogarish bankare (komision mirëmbajtjeje)	1,683	1,401	1,683	1,401
Shpenzime punime në ap. 92.7 m <sup>2</sup> në Sarandë	658,138	548,448	420,096	350,080
Shpenzime udhëtimi TIMS	0	147,474	0	147,474
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	96,800	88,000	96,800	88,000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-269,793</b>	<b>-478,904</b>	<b>-31,751</b>	<b>-280,536</b>

**15.31** Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për sa i përket burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie për vitet 2013 – 2014, ka rezultuar me një balancë negative finale në vlerën -312.287 lekë.

**15.32** Trupi gjykues vlerëson se mungesa e likuiditetit për vitet financiare 2013 – 2014, në total në shumën -312.287 lekë, nuk është në masën që cenon besimin e publikut dhe nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

## **16. Kredi në Credins Bank**

**16.1** Sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.5.2010, për shumën 15.000 euro. Mbyllur në datën 7.12.2016, për vlerën e mbetur 10.675 euro, për efekt të çeljes së një kredie me vlerë të shtuar 21.000 euro. Mbyllja është realizuar nga llogaria e shtetasit F. V., sipas një marrëveshjeje noteriale të datës 5.12.2016, pas kërkesës së bankës. Kredia e re është disbursuar në datën 21.12.2016, në vlerën 21.000 euro. Në datën 22.12.2016 është rikthyer shuma 10.675 euro në llogarinë e shtetasit F. V. Në datën 23.1.2017 është xhiruar shuma për blerjen e automjetit 5.700 euro. Gjendja në datën 24.1.2017, pa u tërhequr 4.755 euro. Qëllimi i shtimit të vlerës së kredisë është shlyerje e detyrimeve të rregullimeve dhe mobilimit shtëpiak, si dhe blerja e automjetit. Kësti mujor: 175 euro. Gjendja e kredisë në datën 24.1.2017 është 4.755 euro, e patërhequr. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

**16.2** Në lidhje me këtë kredi u konstatua se:

- Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar kredi në Credins Bank, me kontratë datë 17.5.2010, në shumën 15.000 euro (shlyerje detyrimi për apartamentin ku banon në \*\*\*).
- Në DPV-të e viteve 2011 – 2015, subjekti ka deklaruar detyrimin financiar kredi bankare në Credins Bank.

- Në DPV-në e vitit 2016, në rubrikën “Përshkrimi i detyrimeve”, subjekti ka deklaruar: (i) kredi në Credins Bank, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.5.2010, për shumën 15.000 euro, mbyllur në datën 7.12.2016. Kredi e re disbursuar në datën 21.12.2016, në vlerën 21.000 euro. Shuma e shlyer nuk është deklaruar. Gjendje detyrimi 21.000 euro; (ii) deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.12.2016, e shtetasve F. V. dhe A. C., me gjendje detyrimi 0 (zero) euro.

### 16.3 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur:

- i) kthim përgjigje nga Credins Bank, datë 5.12.2016, në lidhje me kërkesën e bërë për kredi të re 20.000 euro. Gjendja e kredisë ekzistuese për t’u mbyllur është 10.674,25 euro;
- ii) konfirmim nga Credins Bank datë 24.1.2017, gjendja e llogarisë në datën 24.1.2017 është 4.755 euro;
- iii) kontratë kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.12.2016, në shumën 21.000 euro, me qëllim mobilimi dhe shlyerje detyrimi. Afat 180 muaj. Si garanci për marrjen e kredisë do të vendoset apartamenti me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 120 m<sup>2</sup>, lagjja “\*\*\*”, rruga “\*\*\*”, Tiranë;
- iv) kontratë hipoteke nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.12.2016, mbi pasurinë nr. \*\*\* apartament me sip. 120 m<sup>2</sup>;
- v) deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.12.2016, e shtetasve F. V. dhe Artur Cara, të cilët deklarojnë se: *“Me datë 17.5.2010 është nënshkruar kontrata për kredi afatgjatë me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me Credins Bank, me kredimarrës Artur Cara dhe dorëzanës R. C. Banka në përgjigje të saj sqaron se i aprovon të rrisë limitin e kreditimit pranë kësaj banke për 20.000 euro, porme kushtin që të mbyllet pjesa e mbetur e kredisë ekzistuese në shumën 10.674,25 euro. Për këtë arsye, z. F. V. i jep hua z. Artur Cara shumën 10.675 euro në numrin e llogarisë së këtij të fundit pranë Credins Bank. Z. Artur Cara merr përsipër dhe garanton që me aprovimin e kredisë dhe disbursimin e saj nga Credins Bank të shlyejë z. F. V. për këtë hua. Për këtë shkak, shuma prej 10.675 euro, e cila i përket z. F. V., do të kalojë nga llogaria e z. F. V. në numrin e llogarisë së z. Artur Cara po tek Credins Bank”.*

**16.4** Sipas informacionit të përcjellë nga Credins Bank, rezulton se sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.12.2016, subjekti dhe bashkëshortja janë financuar me një kredi prej 21.000 euro, me objekt kreditimi “Mobilim dhe shlyerje detyrimi me një afat 15-vjeçar”.

**16.5** Para nënshkrimit të kontratës së kredisë së re, në datën 7.12.2016 është kryer transferimi i shumës 10.675,00 euro nga llogaria e shtetasit F. V. në llogarinë e z. Artur Cara, sipas deklaratës noteriale të sipërcituar.

**16.6** Në të njëjtën ditë, shuma e transferuar ka shërbyer për mbylljen para afatit të balancës së mbetur prej 10.676,000 euro të kredisë 15.000 euro të disbursuar në datën 19.5.2010.

**16.7** Në datën 21.12.2016 është disbursuar kredia e re me limit 21.000 euro në llogarinë e subjektit, fondet e së cilës janë përdorur si vijon: (i) është kthyer shuma prej 10.675 euro në llogarinë e shtetasit F. V., në datën 21.12.2016; (ii) është shlyer çmimi i blerjes së automjetit në vlerën 5.700 euro në llogarinë e shitëses S. B. , në datën 23.1.2017; (iii) është tërhequr *cash* në vlerën 4.745 euro nga subjekti, në datën 30.1.2017.

**16.8** Sa më sipër, konstatohet se deklarimi i subjekti është i saktë dhe përputhet me dokumentacionin e administruar.

### **17. Hua e marrë nga shtetasi F. V.**

**17.1** Nga aktet u konstatua se në datën 7.12.2016 shtetasi F. V. i ka dhënë subjektit hua në shumën 10.675 euro, e cila i është kthyer në datën 22.12.2016. Subjekti ka kryer deklarime për këtë hua në deklaratën e vitit 2016.

**17.2** ILDKPKI-ja ka konstatuar se ka burime të ligjshme financiare për dhënie huaje prej 10.675 euro nga shtetasi F. V., me qëllim mbylljen e kredisë së subjektit në Credins Bank. Nga aktet e ndodhura në dosjen e ILDKPKI-së, referuar fakteve dhe provave si vijojnë:

- QKB, DPT, si dhe drejtoritë rajonale Tiranë, Vlorë dhe Elbasan konfirmojnë se shtetasi F. V. figuron në cilësinë e administratorit dhe ortakut në disa kompani.

- ISSH-ja konfirmon kontributet e derdhura për shtetasin F. V. nga shoqëritë “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*” për periudhën janar 2012 – prill 2017.

- ILDKPKI-ja ka administruar vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 28.6.2016, për miratimin e kalimit të diferencës së fitimeve të mbartura prej 24.000.000 lekësh, e cila do të shpërndahet si dividend duke i kaluar në llogarinë e ortakut të shoqërisë F. V.; deklarata vjetore e të ardhurave për vitin 2015 e individit F. V., sipas së cilës të ardhurat e realizuara për periudhën janë 9.232.308 lekë bruto, ndërsa shuma e tatimit të paguar 1.523.093 lekë.

- Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar si në deklaratën *Vetting* sa i takon huas së marrë prej 10.675 euro në dhjetor të vitit 2016 nga shtetasi F. V. dhe përveç dokumenteve të administruara më parë në dosjen e ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur edhe deklaratën vjetore të të ardhurave për vitin 2016 të individit F. V.

- Sa i takon marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me shtetasin F. V., në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti deklaroi se ai është shok dhe mik familjar prej vitesh. Pas verifikimeve, nuk rezultoi konflikt interesi me shtetasin F. V. dhe shoqëritë ku ai figuron administrator/ortak apo përfshirje të tij në veprimtari të krimit të organizuar.

### **Analiza financiare e personit tjetër të lidhur F. V.**

**17.3** Sipas vendimit të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 28.6.2016, është vendosur transferimi i diferencës së fitimeve të mbartura (të pashpërndara) aksionerit F. V.

**17.4** Sipas formularit “Tatim i mbajtur në burim”, vlera prej 3.600.000,00 lekësh i takon tatimit mbi të ardhurat nga dividendë dhe aksione detyrim për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., pagesa e të cilit është bërë nëpërmjet Credins Bank në datën 6.7.2016 (një mandat bankar i pagesës së tatimit në burim në vlerën 3.600.000,00 gjendet në dosje).

**17.5** Sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 8.7.2020, është vërtetuar origjinali i dokumenteve të mësipërme depozituara nga personi F. V.

**17.6** Sipas deklaratës individuale vjetore të të ardhurave (16-A) të shtetasit F. V., është përfshirë edhe e ardhura bruto dhe tatimi përkatës i dividendit të përfituar në bazë të vendimit të asamblesë së ortakëve, cilësuar më lart.

**17.7** Sipas ISSH-së, gjatë vitit 2016 janë paguar sigurimet shoqërore nga 5 subjekte deri në korrik të vitit 2016 dhe nga muaji gusht deri në dhjetor të vitit 2016 nga 4 subjekte mbi pagën bruto 16.054.772 lekë (neto 12.560.454 lekë).

**17.8** Në total, të ardhurat individuale bruto të përfituara nga personi F. V. gjatë vitit raportues 2016 janë në masën 47.451.881 lekë; tatimi i paguar për periudhën është 7.829.470 lekë.

**17.9** Nisur për sa më lart, personi tjetër i lidhur F. V. ka pasur mundësinë financiare që me burime të ligjshme financiare të mundësonte dhënien e huas subjektit të rivlerësimit në shumën 10.675 euro.

## **18. Transaksione të kryera nga bashkëshortja e subjektit**

### **Lidhur me likuiditetet bankare në emër të subjektit e bashkëshortes**

- Llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank Albania, e krijuar nga paga si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Fier (llogari page). Gjendja në datën 24.1.2017 në vlerën 1.048 lekë. Pjesa takuese: 100%.

- Llogari rrjedhëse page në Tirana Bank e bashkëshortes \*\*\*, në lekë. Gjendje *overdraft*-i në datën 23.1.2017 në vlerën -40.208,48 lekë. Pjesa takuese: 100%.

- Llogari rrjedhëse në BKT e bashkëshortes \*\*\*, në lekë. Gjendja në datën 25.1.2017 në vlerën 1.435 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Nga hetimi administrativ nuk u konstatuan problematika.

### **Transaksioni bankar datë 25.11.2009, në BKT, tërheqje znj. R. C., vlera 11.975 euro**

**18.1** ILDKPKI-ja ka administruar: (i) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 8.2.2016, sipas së cilës shtetaset D. A. dhe R. C. deklarojnë se në datën 25.9.2009, në numrin e llogarisë së R. C. pranë BKT-së është depozituar shuma 11.985 euro. Kjo shumë është futur në numrin e llogarisë së R. prej A. M., e cila është vajza e D. A. Shuma është depozituar tek llogaria e R. C., mikeshë e D. A., pasi kjo e fundit nuk kishte llogari të hapur në euro në asnjë nga bankat e nivelit të dytë, në mënyrë që vajza e saj, e cila banonte në Itali, të dërgonte këtë shumë në emër të saj. Shuma është tërhequr nga R. dhe i është dorëzuar D. A., e cila nga ana e saj pranon që e ka marrë këtë shumë. Burimi i kësaj shume është dëmshpërblimi që shtetasja A. M. ka marrë nga shteti italian si pasojë e një aksidenti të ndodhur në Itali; (ii) tërheqje *cash* në valutë, datë 25.11.2009, në BKT, të shumës 11.975 euro, në llogarinë nr. \*\*\*, me përshkrimin “R. M. C. tërheqje nga llogaria”.

- BKT ka informuar se: (i) në llogari të shtetasës R. C., në datën 23.11.2009 është transferuar shuma prej 11.975,00 euro, me përshkrimin “Transferuar nga Xh. D., A. M. (shpenzime familjare)”. Në datën 25.11.2009, në BKT, është bërë tërheqje në *cash* e shumës 11.975 euro nga shtetasja R. M. C.; (ii) shuma ka ardhur nga një bankë në Itali; (iii) shtetasja D. A. ka qenë mbajtëse e dy llogarive bankare në lekë aktive në datën 23.11.2009.

- Subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore burimin e shumës 11.975 euro, si dhe të paraqesë identitetin e plotë të shtetasve Xh. D., A. M. dhe D. A., i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 3 vijon të deklarojë se burimi i kësaj shume është dëmshpërblim nga një aksident i ndodhur në Itali në datën 27.7.2007 në dëm të vajzës së saj A. M.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**18.2** Në parashtrimet e tij, subjekti i rivlerësimit, për sa i përket transferimit të shumës 11.975 euro në vitin 2009, në llogarinë e bashkëshortes së tij pranë BKT-së, duke theksuar se ky veprim është kryer për të lehtësuar miken e saj, shtetasen D. A., e cila nuk dispononte llogari në monedhën euro. Shuma e transferuar është e përfituar nga e bija e D., A. M., si dëmshpërblim për aksidentin automobilistik rrugor.

**18.3** Shtetasja A. M., e datëlindjes 3.9.1972, lindur në Krujë dhe banuese në Pove del Grappa, Itali, me shtetësi italiane, është rezidente në këtë qytet prej vitit 1995. Nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 3.7.2023, para noterit G. F. në Bassano del Grappa, shtetasja A. M. ka deklaruar se në datën 23.7.2007 ka pësuar një aksident automobilistik ndërsa ishte në drejtim të mjetit të saj “Renault Clio” me targë \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*” të qytetit Pove del Grappa. Për shkak të dëmtimeve nga aksidenti është shtruar në spitalin e qytetit Bassano del Grappa, ku i është nënshtruar ekzaminimeve dhe kujdesit mjekësor.

**18.4** Në lidhje me aksidentin automobilistik, shtetasja A. M. ka ndjekur procedurat administrative të dëmshpërblimit pranë shoqërisë së sigurimeve “\*\*\*\*” në qytetin Bassano del Grappa, sheshi “\*\*\*\*” nr. \*\*\*. Meqenëse pas procedurave është gjendur fajtor drejtuesi i mjetit tip “Volkswagen”, shtetasja A. M. ka përfituar dëmshpërblim monetar. Edhe vajza e saj M. D., e përfshirë në aksident, është shtruar në spitalin \*\*\*, ku i është nënshtruar kujdesit mjekësor deri në datën 27.7.2007, kur ka dalë nga spitali, bazuar në dokumentacionin mjekësor të vënë në dispozicion nga spitali \*\*\*, datë 27.7.2007, si dhe ekzaminimi mjekësor për shtetasen A. M. (D.), kryer në datën 15.12.2007 nga mjeku kirurg C. G. Aktet mjekësore specifikojnë dëmtimet e shkaktuara dhe kurën e ndjekur mjekësore pas aksidentit datë 23.7.2007.

**18.5** Sipas subjektit, shuma e transferuar me transparencë nëpërmjet llogarisë bankare të bashkëshortes është tërhequr prej saj në datën 25.11.2009, në prani të shtetasës F. A., kunata e shtetasës D. A.

**18.6** Në vijim, ajo i ka riinvestuar përsëri në bono thesari dhe në datën 20.6.2011 këto fonde janë tërhequr nga shtetasja F. A. dhe i janë dorëzuar përfitueses D. A., e cila ka vijuar të riinvestojë thujse të njëjtën shumë në bono thesari, me afat maturimi 6-mujor, në datën 27.6.2011, në llogarinë e saj në BKT.

**18.7** Në vijim të sa më sipër, subjekti kërkon që kjo shumë të mos përfshihet në analizën financiare dhe se ai e ka provuar burimin e ligjshëm.

**18.8** Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti ka paraqitur:

- deklaratë noteriale datë 3.7.2023, e shtetasës A. M., para noterit G. F.;
- dokumente mjekësore lëshuar nga \*\*\*, datë 27.7.2007;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.2.2016, e shtetasës D. A.;
- deklaratë noteriale datë 6.7.2023, e shtetasëve F. A. dhe D. A., si dhe ekstrakti i lëvizjes së llogarisë bankare të shtetasës F. S. A. në BKT, me nr. \*\*\*, në monedhën lekë; duket depozitimi i shumës prej 1.600.000 lekësh në llogarinë e shtetasës F. A. në datën 25.11.2009 nga vetë ajo dhe transferimi në bono thesari;
- foto dokumentuese të aksidentit të datës 23.7.2007, vënë në dispozicion nga shtetasja A. M.; në foto nuk ka datë.

**18.9** Nisur nga fakti që ky aksident është bërë objekt i shtypit lokal, publikuar në gazetën lokale të Vicenzës, “\*\*\*\*”, bashkëshortja e subjektit, nëpërmjet *email*-it të datës 30.6.2023 i ka kërkuar redaksisë vënien në dispozicion të artikullit datë 24.7.2007, lidhur me aksidentin (bashkëlidhur



foto e nxjerrë nga portalet respektive). Në përgjigjen e datës 4.7.2023, redaksia i ka kthyer përgjigje që këto botime nuk janë më të disponueshme, për shkak të kohës së gjatë.

**18.10** Subjekti thekson se shtetasja A. M. ka deklaruar në deklaratën noteriale të datës 3.7.2023 se nuk ka mundur të disponojë dokument provues nga banka “Volksban”, ku ka thyer çekun e marrë nga \*\*\*, pasi kjo bankë ka përthithur/ka blerë aksionet e \*\*\*, për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar, parashikuar në nenin 2220 të Kodit Civil Italian.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**18.11** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton se:

- Në analizë të arsyetimit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga dokumentacioni i siguruar prej tij subjekti arriti të provojë se shtetasja A. M. dhe vajza e saj M. janë përfshirë në një aksident në vitin 2007. Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nga të gjitha faktet e prezantuara më sipër, si dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë dhe të provojë me provat që njeh legjislacioni procedural situatën faktike e të japë një shpjegim për rrethanat e pretenduara prej tij në aspektin logjik.

**18.12** Nga provat e administruara në hetim nuk rezultoi asnjë fakt i dalë që të vërë në dyshim vërtetësinë e këtyre rrethanave, por rezultuan prova të tjera që mbështesnin këtë qëndrim të subjektit të rivlerësimit.

#### **Transaksion bankar datë 22.4.2010, në BKT, tërheqje znj. R. C., vlera 11.500 euro**

**18.13** Nga verifikimi i veprimeve bankare rezulton se në datën 21.12.2009 ka një depozitim *cash* nga shtetasja R. C. në llogarinë e saj në BKT (\*\*\*), në shumën 9.900 euro, që sipas deklaratës noteriale datë 18.2.2016, shtetasit M. P. dhe Ll. Z. ia kanë dhënë shtetasës R. C., e cila i ka tërhequr në datën 22.4.2010, në vlerën 11.500 euro (pasi është përfshirë edhe qiraja për periudhën janar – mars 2010 prej 1.620 euro (transferuar në datën 15.2.2010 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.). Sipas deklaratës noteriale të datës 18.2.2016, kjo vlerë i është dhënë nga znj. C. në datën 25.4.2010, për shkak se iu është nevojitur për mobilim të apartamentit, deklarim të cilin e ka dhënë edhe gjatë pyetjes pranë ILDKPKI-së në shkurt të vitit 2016.

**18.14** Nga verifikimi i të dhënave në sistemin TIMS rezulton se shtetasja M. P. ka hyrë në Shqipëri në datën 10.12.2009 dhe ka dalë në datën 29.4.2010, për t’u rikthyer më 14.4.2011, pra në periudhën që nga depozitimi i shumës *cash* deri në tërheqjen e saj ajo ka qenë në Shqipëri. Nga hetimi administrativ shtetasja M. P. nuk rezulton të ketë llogari bankare.

**18.15** Në deklarimin e interesave privatë para fillimit të detyrës së vitit 2009, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura në llogari në BKT, në shumën 600 euro/muaj, si person i autorizuar me prokurë për tërheqjen e tyre nga pronari Ll. Z.

**18.16** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjektit i janë kërkuar sqarime në lidhje me mënyrën e dhënies së shumës 9.900 euro nga shtetasi Ll. Z. etj. dhe subjekti nuk ka dhënë një përgjigje shteruese, duke u mjaftuar vetëm me deklarimin që fondet e tërhequra nga shtetasja R. C. janë

përdorur nga pronarët e pasurive. Ndërkohë pohon se shuma prej 9.900 euro që i është dhënë bashkëshortes i përkiste shtetasit Ll. Z.

**18.17** Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente në lidhje me: (i) përse shuma 9.900 euro i është dhënë *cash* nga ana e Ll. Z. dhe/ose M. P. shtetasas R. C., e cila i depozitoi *cash* në llogarinë e saj personale në BKT, në datën 21.12.2009, për t'ia kthyer sërish *cash* disa muaj më vonë në datën 25.4.2010, ndërkohë që sipas sistemit TIMS shtetasja M. P. ka qenë në Shqipëri gjatë gjithë kësaj periudhe dhe mund ta administronte vetë këtë shumë; (ii) mbetet e paqartë se pse kjo shumë nuk ka kaluar në rrugë bankare në llogarinë e përbashkët të shtetasit Ll. Z. me bashkëshorten e subjektit. Në këto kushte, në analizën financiare të vitit 2009, shuma 9.900 euro, depozituar në datën 21.12.2009 nga shtetasja R. C., është konsideruar si pasuri e saj. Ky vit rezulton me balancë negative (shihni analizën financiare përfundimtare).

**18.18** Gjithashtu, nga dosja e ILDKPKI-së dhe deklaratimet e subjektit në pyetësonin standard, rezultoi se:

- Me prokurë të posaçme datë 21.2.2000, me vërtetimin nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.2.2000, të noteres K. P., ku shtetasit M. P. dhe Ll. Z. emërojnë si përfaqësuesen e tyre bashkëshorten e subjektit R. L., me të cilën kanë lidhje farefisnore, që për llogarinë e tyre të kryejë blerjen e një dyqani me sip. 100 m<sup>2</sup> pranë shoqërisë “\*\*\*\*” në bllokun “\*\*\*\*” deri në mbylljen e kontratës përfundimtare. Sipas prokurës shtetasas R. C. i është dhënë e drejta edhe e kryerjes së pagesave të kësteve për blerjen e pasurisë.

- Me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.10.2001, shtetasit Ll. Z., Xh. Z. dhe M. P. kanë blerë dyqanin nr. \*\*\* te objekti nr. \*\*\*, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në çmimin 4.280.000 lekë, likuiduar totalisht, e cila është nënshkruar personalisht nga të dyja palët.

- Me kontratë sipërmarrjeje datë 2.3.2005, lidhur mes sipërmarrësit “\*\*\*\*” dhe porositësve Ll. Z. dhe Xh. Z., këta kanë porositur një apartament me sip. 107 m<sup>2</sup>, kontratë e nënshkruar nga vetë palët. Nga të dhënat bankare dhe deklaratimet e subjektit rezulton që shtetasja R. C. ka kryer transaksione bankare për pagimin e çmimit të shitjes.

- Me kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.12.2006, shtetasja R. C., e cila disponon prokurën nr. \*\*\*, datë 21.2.2000, i jep me qira shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. një dyqan të ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë 600 euro/muaj, për një periudhë pesëvjeçare. Nga të dhënat bankare rezulton se pagesat e qirave kanë kaluar në llogari të bashkëshortes së subjektit në periudhën 2007 – 2011.

- Me deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.2.2016, administruar nga ILDKPKI-ja, por paraqitur edhe nga subjekti në përgjigje të pyetësonit standard, shtetasit M. P. dhe Ll. Z. deklarojnë se në vitin 2000 kanë porositur për ndërtim pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. një dyqan, i cili aktualisht është i regjistruar në emër të shtetasve Ll. Z., Xh. Z. dhe M. P. Për të kryer procedurat e nevojshme deri në lidhjen e kontratës përfundimtare të shitblerjes, nëpërmjet një prokure të posaçme (nr. \*\*\*, datë 21.2.2000) kanë emëruar përfaqësuesen e tyre R. L. (C.), meqë ata jetonin në Greqi dhe aq më tepër që R. është mbesa e shtetasas M. P. Përveç dyqanit, tek po e njëjta shoqëri është porositur edhe një apartament me sip. 107 m<sup>2</sup> dhe R. ka qenë përfaqësuese e tyre në këtë shoqëri. Gjithashtu, R. i ka përfaqësuar edhe në marrëdhëniet me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., të cilës i kishin dhënë me qira dyqanin e sipërcituar. Për këto arsye, shtetasas R. C. i dërgoheshin vazhdimisht vlera monetare, me bankë ose *cash*, ndërmjet të

cilave i është dërguar shuma 9.900 euro, depozituar në llogarinë e saj më 21.12.2009. Theksohet se në këtë numër llogarie derdhej nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. qiraja e dyqanit më sipër. Pas disa muajsh, në prill të vitit 2010, shuma 9.900 euro i është kërkuar për mobilimin e shtëpisë dhe në datën 25.4.2010 shtetasja R. C. ka kthyer shumën 11.500 euro, pasi diferenca është një këst qiraje dyqani.

- Nga të dhënat bankare vërtetohet se bashkëshortja e subjektit ka pasur një llogari të përbashkët me shtetasin Ll. Z. pranë Bankës Kombëtare të Greqisë (NBG), llogari e hapur në datën 10.12.2001 dhe mbyllur në datën 29.1.2014 pranë Bankës Kombëtare të Greqisë (blerë nga ABI Bank në vitin 2018). Janë evidentuar kreditime në këtë llogari në vlerën 85.002 euro dhe debitime (tërheqje *cash*/transferime) në vlerën 84.512 euro deri në datën 26.6.2009.

**18.19** Ndodhur përpara provave dhe rrethanave të sipërpërmendura, Komisioni ka kryer hetime në lidhje me një njësi dhe një apartament banimi, të blera nga shtetasi Ll. Z. etj., me qëllim heqjen e çdo dyshimi që subjekti apo bashkëshortja e tij mund të kenë lidhur me këto pasuri.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**18.20** Në parashtrimet e tij subjekti dha sqarime në lidhje me marrëdhënien e veçantë dhe gatishmërinë e saj për t’i ndihmuar familjarët e saj, referuar deklaratave noteriale të tyre depozituar pranë Komisionit.

**18.21** Ai theksoi se shuma është kërkuar të depozitohet *cash* në llogarinë e bashkëshortes në BKT, ku kanalizoheshin edhe qiratë e dyqanit në pronësi të hallës së saj dhe familjes Z., me qëllim që kjo shumë të tërhiqej së bashku me qiratë e akumuluar për t’u investuar në mobilimin e apartamentit ku ata jetojnë.

**18.22** Për sa i takon arsyes përse kjo shumë nuk është depozituar në llogarinë që shtetasi Ll. Z. ka pasur në NBG me bashkëshorten e tij, ai sqaron se ky depozitim i shumës nuk është kërkuar nga mbajtësi i llogarisë dhe ai nuk ka dijeni të saktë për arsyen pse, por thekson se për bashkëshorten nuk kishte asnjë lloj rëndësie se në cilën llogari do të derdreshin likuiditetet, për shkak se ajo thjesht ofronte ndihmesën e saj dhe ka ekzekutuar transaksione bankare në përputhje me kërkesat e palës së interesuar.

**18.23** Subjekti kërkon nga Komisioni mospërfshirjen e shumës 9.900 euro në analizën financiare, pasi ajo shumë nuk ka si i përket familjes së tij, sepse nuk ka asnjë marrëdhënie interesi, tagër për ta përfituar apo për ta përdorur këtë shumë.

**18.24** Subjekti ka deklaruar: *“Përdorimi i shumave monetare që i përkasin dikujt tjetër do të ishte në shkelje të etikës së marrëdhënieve familjare, njerëzore dhe nuk po shkoj më tej me cenimin e integritetit të etikës sonë familjare, ndërkohë që prejardhja është nga familje të nderuara të kësaj shoqërie. Për kohën, përkushtimi i bashkëshortes ishte i natyrshëm, i zhvendosur në kohë, sot, në kuadër të këtij procesi mund edhe të paragjykohet. Por ridekloroj para Komisionit se në asnjë rast as nuk është menduar që kjo shumë monetare mund të përdorej për nevoja të familjes së tij”*.

**18.25** Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti ka paraqitur:

- deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.6.2023, notere I. T., të shtetasës M. P.;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.2.2016, e shtetasve Ll. Z. dhe M. P.;
- deklaratë përgjegjësie (sipas nenit 8 N.\*\*\*), datë 28.6.2023, e shtetasit Ll. Z.;

- preventiv porosie të mobilieve të znj. M. P., lëshuar nga subjekti “\*\*\*\*” (NIPT \*\*\*) me adresë \*\*\*, Fushë-Krujë, në datën 12.2.2010, shuma 720.000 lekë.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**18.26** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyetën se:

- Në analizë të arsyetimit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, duke mbajtur në konsideratë se nga bashkëshortja e subjektit është deklaruar që në deklarinimin e interesave privatë para fillimit të detyrës 2009, marrëdhënia me këta familjarë të saj ka deklaruar të ardhura në llogari në BKT në shumën 600 euro/muaj, si person i autorizuar me prokurë për tërheqjen e tyre nga pronari Ll. Z., duke vlerësuar se kjo marrëdhënie datonte sipas dokumentacionit ligjor të administruar gjatë hetimit administrativ prej vitit 2000 para fillimit të punës nga subjekti dhe para martesës së tyre, Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me arsyet dhe qëllimin e kryerjes së këtyre transaksioneve nga bashkëshortja e tij, duke arritur në përfundimin se nuk kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**18.27** Në lidhje me një njësi dhe një apartament banimi, të blera nga shtetasi Ll. Z. etj., provat e referuara nga hetimi administrativ, shpjegimet e subjektit dhe deklaratimet e tij në seancë mbi këto marrëdhënie të bashkëshortes të krijuara para lidhjes së martesës së tyre dhe duke mbajtur në konsideratë edhe konkluzionin mbi transaksionet e bashkëshortes me familjarët e saj, trupi gjykues ka vlerësuar se nuk provohen nga hetimi administrativ përpjekje të subjektit për të fshehur pasurinë e tij, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**Gjatë procesit të hetimit, Komisioni verifikoi edhe llogarinë bankare në BKT, në monedhën euro, në emër të bashkëshortes së subjektit, ku janë kryer depozita me afat.**

**18.28** Në analizë të veprimeve bankare, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve lidhur me burimin e shumës 10.500,00 euro, depozituar nga bashkëshortja e subjektit, fillimisht, në datën 23.5.2005 (dhe destinacioni i përdorimit të tyre pas tërheqjes *cash* të vlerës 11.318,18 euro, në datën 29.6.2006).

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**18.29** Në parashtrimet e tij, subjekti sqaron burimin e shumës 10.500 euro, derdhur *cash* nga bashkëshortja: (i) në datën 23.5.2005, shuma 36.370 euro është tërhequr nga shtetasi turk H. K. T. V., përfaqësues i shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k. Kjo shumë është përfituar nga transferimi i shumës së kredisë së disbursuar pranë NBG-së sh.a., në llogarinë e shtetasit Ll. Z., në datën 20.5.2005; (ii) nga kjo shumë është lëshuar nga shoqëria ndërtuese mandatarkëtimi në vlerën 25.400 euro në të njëjtën datë, më 23.5.2005, dhe diferenca prej 10.970 euro u mbajt nga shtetasi Ll. Z.; (iii) me arsyetimin më sipër, sipas subjektit provohet edhe dhënia nga shtetasi Ll. dhe Xh. Z. e shumës 10.500 euro, depozituar në të njëjtën datë në llogarinë e çelur

nga bashkëshortja në BKT sh.a., depozitë me afat 6-mujor, nga e cila në datën 23.6.2005 është tërhequr *cash* shuma 10.000 euro, ridepozituar më 16.12.2005, shuma 10.700 euro, tërhequr më 29.6.2006, shuma 11.318,50 euro, e cila iu kthye bashkëshortëve Z., ashtu si deklaruar prej tyre në deklaratat ligjore.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**18.30** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton se:

- Nga gjithë sa shpjeguar e analizuar më sipër, subjekti arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues se shuma 10.500 euro nuk është përfituar nga bashkëshortja dhe nuk është vënë në funksion të financave të tij dhe, për këtë arsye, kjo shumë nuk duhet të përfshihet në likuiditetet e tij në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

**18.31** Në konkluzion, për sa i përket transaksioneve të kryera nga bashkëshortja, trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka pasaktësi, pasi nuk ka deklaruar transaksionet e kryera nga bashkëshortja në llogaritë e përbashkëta apo në emër dhe për llogari të familjarëve të saj apo/dhe transaksionet me pasuritë e paluajtshme të përfaqësuarve prej saj me prokurën e vitit 2000, por u provua se ato nuk janë kryer për fshehje pasurie nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, ndaj dhe nuk duhet të ndikojnë në analizën e përgjithshme financiare të subjektit të rivlerësimit apo, në konkluzionin e përgjithshëm, mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

**18.32** Ky qëndrim i mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave.

**18.33** Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat e konstatuara nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe nuk kanë afektuar deklarimin e tij në deklaratën *Vetting* të vitit 2017.

## **19. Automjet tip “Opel Zafira”**

**19.1** Në DPDFD-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar automjet tip “Opel Zafira”

**19.2** Gjatë procesit subjektit iu kërkua të informojë mbi këtë automjet dhe faktit të mosdeklarimit të tij në deklarinimet e mëpasme dhe në deklaratën *Vetting*..

**19.3** Në përgjigje, subjekti deklaroi se: “*Mjeti i deklaruar në DPDFD-në e vitit 2009 pësoi dëm të riparueshëm nuk u regjistrua e nuk u përdor. Subjekti deklaroi se nuk disponon dokumentacion*”.

**19.4** Komisioni verifikoi në sistemin e AMF-së nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, në vitin 2012, kishin prerë policë sigurimi të një automjeti të së njëjtës markë dhe model, Opel Zafira, me targë \*\*\*, në pronësi të shtetasit S. L.

**19.5** Me qëllim verifikimin nëse automjeti “Opel Zafira”, me targë \*\*\*, është i njëjti automjet “Opel Zafira”, deklaruar nga subjekti në vitin 2009, u kërkua dosja DPSHTRR-së.

**19.6** Nga verifikimi i dosjes rezultoi se sipas certifikatës së pronësisë datë 16.11.2010, shtetasi D. P. i shet automjetin shtetasit S. L., në shumën 700 euro. Sipas deklaratës doganore datë 26.10.2011, detyrimet doganore në shumën 54.617 lekë, u shlyen nga shtetasi S. L.

**19.7** Sipas lejes së qarkullimit, ky automjet i regjistruar në pronësi të shtetasit S. L., me targë \*\*\*, në vitin 2017, u shit tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**19.8** Sa më sipër, automjeti me targë \*\*\*, në pronësi të shtetasit S. L., nuk ka rezultuar ai i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2009.

**19.10** Komisioni, pasi analizoi deklaratimet e subjektit lidhur me këtë automjet, si dhe pasi verifikoi sa më sipër vlerësoi se subjekti duhet të deklaronte në deklaratën *Vetting*, gjithë situatën e referuar gjatë shpjegimeve lidhur me këtë automjet.

**19.11** Përtej kësaj pasaktësie në deklaram, faktet e hetimit nuk krijuan dyshime për fshehje të kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit.

**20.** Me deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.7.2009, me palë shitëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., palë blerëse R. M. C. dhe P. I. Z., në shumën 51.370 euro, me burim: “*Kjo shumë ishte depozituar nga P. Z., për të prenotuar një dyqan dhe një apartament në pallatin D, i pandërtuar akoma dhe do t’i kthehet atij me katër këste, nëpërmjet BKT-së Tiranë*”. Objekti i kontratës “Likuidim nga ana e shoqërisë e shumës 51.370 euro”.

**20.1** Duke qenë se në të njëjtën datë dhe numër repertori e numër koleksioni të mëparshëm, rezultoi të jetë lidhur kontrata e blerjes nga ana e subjektit dhe e bashkëshortes së apartamentit në Larakë, objekt verifikimi trajtuar më lart, Komisioni kreu verifikimet si vijon:

i) Subjektit iu kërkua ta vërë në dispozicion këtë deklaratë dhe të japë sqarime të plota dhe shteruese në lidhje me qëllimin e saj, si dhe marrëdhënien me shtetasin P. Z.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se shtetasi P. Z. është person i panjohur prej tyre. Sipas subjektit, në aktin noterial rezulton vetëm shtetasi P. Z. Subjekti shpjegoi se nisur nga fakti që deklaratimet bëheshin *online* për DPPPP-në, mund të ketë pasur probleme teknike të funksionimit të sistemit në hedhjen e të dhënave, pasi veprimi noterial është kryer pas përpilimit të kontratës së shitjes së apartamentit.

Në mbështetje të deklaratimit të tij, subjekti paraqiti kopje noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.7.2009, me palë deklaruese shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasi P. Z. Nga përmbajtja e kësaj deklarate rezulton se shoqëria i ka kthyer shumën e caktuar shtetasit P. Z., pasi kjo shumë e dhënë nga ky i fundit për prenotimin e një dyqani ishte përvetësuar nga ish-përfaqësuesi i shoqërisë dhe nuk ishte derdhur në zyrën e financës dhe as në llogarinë e shoqërisë.

ii) U kërkua tek noterja kopje e plotë e praktikës së deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.7.2009. Kjo e fundit vuri në dispozicion<sup>6</sup> deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.7.2009, me dokumentacionin shoqërues.

Iu kërkua noteres I. T.<sup>7</sup> informacion mbi raportimin e shtetasës R. C. dhe fleta e regjistrit. Kjo e fundit dha informacione të hollësishme mbi veprimet e datës 18.7.2009 dhe raportimet përkatëse të bëra në DPPPP, duke shpjeguar se meqenëse deklarata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. është bërë menjëherë pas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., mendon se sistemi automatik i

<sup>6</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2023, të noteres I. T., në dosjen e Komisionit.

<sup>7</sup> Shihni shkresën datë 27.5.2023 të noteres I. T., protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 29.5.2023, në dosjen e Komisionit.

DPPPP-së ka mbartur emrin e shtetasës R. C. Noterja deklaroi se shtetasja R. C. nuk ka asnjë lidhje me këtë deklaratë noteriale, si dhe vuri në dispozicion, ndër të tjera, dokumentin nr. \*\*\* për raportimin e transaksionit për deklaratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., ku nuk figuron emri i shtetasës R. C., si dhe fletën e regjistrit noterial.

**20.2** Sa më sipër, Komisioni i vlerësoi bindëse sqarimet e subjektit të rivlerësimit, duke arritur në përfundimin se nga dokumentacioni i administruar nuk provohet asnjë lloj lidhjeje e shtetasës R. C. me këtë pasuri.

**20.3** Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë pasuri apo dyshime lidhur me pasuri të fshehur të subjektit.

### **Analiza financiare**

**20.4** Për të verifikuar justifikimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*, të krijuara gjatë periudhës së rivlerësimit, është kryer analiza financiare e subjektit bazuar në vlerën e pasurive, të ardhurat dhe shpenzimet dhe, në përfundim të hetimit administrativ, subjektit iu kalua barra e provës për balancat negative të rezultuara nga analiza financiare para dhe pas fillimit të detyrës.

**20.5** Trupi gjykues analizoi prapësimet e subjektit për: (i) ndryshimet në gjendjen e likuiditeteve për shkak të mospërfshirjes në analizë të likuiditeteve që u përkasin të afërmeve, familjarëve, cilësuar nga ana e Komisionit si persona të tjerë të lidhur; (ii) ndryshimet në përlllogaritjet e shpenzimeve të udhëtimeve të anëtarëve të familjes jashtë territorit të vendit, të provuara me dokumentacion si të mbuluara nga familjarët dhe në udhëtimet në vendin e punës për vitin 2005; (iii) përdorimin e fondeve të kredisë, financuar nga Credins Bank në datën 19.5.2010, për mobilim dhe rikonstruksion të apartamentit me sip. 120 m<sup>2</sup>, në Tiranë; (iv) shpërndarjen e shpenzimeve të punimeve për apartamentin në Sarandë.

**20.6** Komisioni, përveç ndryshimeve në disa prej zërave të analizës financiare të pasurive të trajtuara më hollësisht në këtë vendim<sup>8</sup>, ka marrë në konsideratë ndryshimin e disa shpenzimeve të udhëtimit të subjektit dhe familjarëve të tij, më konkretisht në vitet 2007, 2008 (provuar me deklaratën noteriale datë 20.7.2020) dhe 2010.

**20.7** Për shpenzimet e tjera të udhëtimit jashtë vendit për vitet 2004, 2011 dhe 2016 nga ana e Komisionit nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e subjektit, për shkak se ato mbeten në nivel deklarativ.

**20.8** Për shpenzime udhëtimi për vendin e punës për vitin 2005, reflektuar ndryshimi për sa u provua se prej muajit tetor 2005 është komanduar oficer i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë, është rishikuar ky zë shpenzimi për vitet 2005 – 2007.

**20.9** Shuma e tërhequr *cash* në maj të vitit 2010 prej 14.700 euro, e përfituar nga kredia e disbursuar po në datën 19.5.2010, është pasqyruar në analizën financiare për vitin 2010, e ndarë në dy zëra shpenzimesh: vlera 5.130 euro, shpenzuar për mobilimin e apartamentit me sip. 120 m<sup>2</sup>, në Tiranë, ndërsa vlera e mbetur 9.570 euro është pasqyruar si shpenzim për punimet në këtë apartament, referuar parashtrimeve të subjektit<sup>9</sup>.

<sup>8</sup> Analiza financiare për: (i) blerjen për apartamentin me sip. 120 m<sup>2</sup>, në Tiranë, trajtuar në paragrafin nr. 14; (ii) blerjen dhe shpenzimet për përfundimin e punimeve për apartamentin me sip. 72.9 m<sup>2</sup>, në Sarandë, të trajtuar në paragrafin nr. 15.

<sup>9</sup> Për paraqitjen e ekuivalentit të kredisë së disbursuar në datën 19.5.2010 dhe shumave të shpenzuara në maj 2010, në analizën financiare të këtij viti është përdorur kursi zyrtar i këmbimit të muajit maj kur është disbursuar dhe shpenzuar kredia (euro/lekë = 136.68).

**20.10** Për sa i përket depozitimit *cash* në shumën 9.900 euro, në datën 21.12.2009, në BKT, së bashku me qiratë e dyqanit në pronësi të familjarëve të saj, trupi gjykues, referuar arsyetimit mbi transaksionet e bashkëshortes për familjarët e saj, vendosi moskonsiderimin e kësaj shume si pasuri në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij. Si rrjedhojë, analiza financiare e periudhës 10.12.2009 – 31.12.2009 nga balanca negative prej -1.351.693 lekësh, rezultoi me balancën pozitive prej 6.290 lekësh.

**20.11** Në përfundim, pas rishikimit të analizës financiare, pamundësia financiare e subjektit dhe personit të lidhur, gjatë ushtrimit të detyrës 10.12.2009 – 2016 rezulton në vlerën -599.363 lekë, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

Periudha	1. Pasuri	2. Të ardhura	3. Shpenzime	Mundësia për kursim (2-1-3)
1995 – 10.12.2009	7,458,833	10,574,782	3,991,505	- 875,556
10.12.2009 – 31.12.2009	12,280	42,846	24,276	6,290
2010	129,254	3,588,236	3,155,805	271,227
2011	-105,506	1,533,582	960,959	678,129
2012	616,445	1,711,363	1,287,749	- 192,831
2013	54,455	1,650,192	1,627,489	- 31,751
2014	174,267	1,864,856	2,005,325	- 314,736
2015	24,604	1,526,162	1,561,603	- 60,045
2016	441,158	6,051,724	4,657,531	953,035

**20.12** Pamundësia financiare para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, e rishikuar sipas tabelës së mësipërme, pas kalimit të barrës së provës, nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit.

### **Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**21.** Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij.

**22.** Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve gjatë krijimit të pasurisë në vitet 2013 – 2014, në vlerën -312.287 lekë dhe, në total, në analizën financiare gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës të subjektit të rivlerësimit, në vlerën -599.363 lekë, nuk janë në masën që ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë.

**23.** Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit është në përputhje me detyrimet ligjore që subjekti i rivlerësimit ka pasur për të bërë në zbatim të legjislationit.

**24.** Pamundësia financiare para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të tij.

**25.** Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, ka pasur burime



financiare të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e pasurisë, si dhe nuk ka kryer deklarin të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

**26.** Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, rrethanat e konstatuara në vlerësimin e komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur nga trupi gjykues se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Cara, ka arritur një nivel të besueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**27.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

**28.** Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur B. Cara, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.6.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**29.** Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur B. Cara.*

**30.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

### **Konkluzion i Komisionit mbi kontrollin e figurës**

**31.** Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në konkluzionin se konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Cara.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**32.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, z. Artur B. Cara, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 25.4.2023; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit, të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **ANALIZA E GJETJEVE**

#### **Aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Prokurori Artur Cara shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi, ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë, si dhe identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Artur Cara, për vitin 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit është vlerësuar “shumë mirë”.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Cara, shfaq aftësi në arsyetim ligjor, tregon kujdes që konkluzionet e tij të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsyetimeve. Bën analizë të normave të ligjeve përkatëse, Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

### **Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës prokurori ka trajtuar 402 çështje. Prokurori Artur Cara tregon vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrin total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore*

Prokurori Artur Cara kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve. Qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga ana e subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

#### *b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Artur Cara, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *c) Paanësia*

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Artur Cara. Nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nuk është konstatuar

përdorim i gjuhës diskriminuuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

Nga 3 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e përzgjedhura në short vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Artur Cara për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

#### *c) Gatishmëria për t’u angazhuar*

Subjekti Artur Cara rezulton se ka marrë pjesë në 11 trajnime me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

### **Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale**

**33.** Trupi gjykues konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit, z. Artur Cara, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **DENONCIME**

**34.** Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka analizuar 5 denoncimet për subjektin e rivlerësimit, si vijon:

#### **34.1 Denoncim nga shtetasi N. Rr. D.**

Denoncuesi ngre pretendime ndaj disa prokurorëve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, z. Artur Cara, dhe disa funksionarëve shtetërorë për: falsifikim të dokumenteve dhe fshehje të produkteve të veprës penale; kontakte të prokurorëve me ish-prefektin dhe kryetarin e Bashkisë \*\*\*; zvarritje të proceseve duke mos kryer hetim. Bashkëngjitur ka paraqitur në formën e kallëzimeve penale ndaj disa prokurorëve, si dhe disa vendime mosfillimi procedimi penal nga disa prokurorë, përfshirë edhe 4 vendime mosfillimi procedimi penal nga subjekti i rivlerësimit për kallëzimet penale të bëra nga shtetasi N. D., për të cilat ka marrë dijëni sipas shkresave përkatëse. Në të katër vendimet e mosfillimit subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se faktet e kallëzuara janë hetuar nga Prokuroria në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*, etj. dhe hetimi sërish do të përbënte cenim të parimit të gjësë së gjykuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesi, vërehet se ai ka bërë disa kallëzime penale që kanë të bëjnë me falsifikimin e dokumenteve për pasurinë nr. \*\*\*, ndodhur në fshatin \*\*\*. Rezulton se mbi këto pretendime është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, hetuar nga prokurorja M. M., e cila në përfundim, në datën 15.5.2014, ka vendosur pushimin e këtij procedimi.

Në vijim denoncuesi ka paraqitur disa kallëzime penale, ndër të tjera, edhe:

- Kallëzim penal nr. \*\*\* ndaj shtetasit K. K., për deklaram të rremë para noterit, si dhe deklaram të rremë para oficerit të policisë gjyqësore, për të cilin në datën 19.11.2014 është vendosur

mosfillim nga prokurori Artur Cara, me arsyetimin se për të njëjtin fakt ka paraqitur kallëzim dhe është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, i cili është pushuar dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin datë 11.11.2014 dhe se hetimi sërish do të përbënte cenimin e parimit të gjësë së gjykuar. Bazuar në nenet 24.2, 290 shkronja “e” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal.

- Kallëzim penal nr. \*\*\* ndaj shtetases A. P., për deklaram të rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe shpërdorim detyre. Prokurori Artur Cara, në datën 5.3.2015, ka vendosur mosfillimin e procedimit duke arsyetuar se Prokuroria ka hetuar më parë në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\* dhe kallëzimeve nr. \*\*\*, nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, duke vendosur mosfillimin e tyre, vendime të cilat janë ankimuar dhe janë në proces shqyrtimi nga gjyqësori dhe hetimi sërish përbën cenim të parimit të gjësë së gjykuar.

- Kallëzim penal nr. \*\*\* ndaj shtetasit A. D., për deklaram të rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe shpërdorim detyre. Prokurori Artur Cara, në datën 5.3.2015, ka vendosur mosfillimin e procedimit, duke arsyetuar se Prokuroria ka hetuar më parë në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\* dhe kallëzimeve nr. \*\*\*, nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, duke vendosur mosfillimin e tyre, vendime të cilat janë ankimuar dhe janë në proces shqyrtimi nga gjyqësori dhe hetimi sërish përbën cenim të parimit të gjësë së gjykuar.

- Kallëzim penal nr. \*\*\* ndaj shtetasit L. Z., për deklaram të rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe shpërdorim detyre. Prokurori Artur Cara, në datën 5.3.2015, ka vendosur mosfillimin e procedimit duke arsyetuar se Prokuroria ka hetuar më parë në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\* dhe kallëzimeve nr. \*\*\*, nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, duke vendosur mosfillimin e tyre, vendime të cilat janë ankimuar dhe janë në proces shqyrtimi nga gjyqësori dhe hetimi sërish përbën cenim të parimit të gjësë së gjykuar.

Me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit për zvarritje të proceseve, duke mos kryer hetim gjatë procesit, subjektit iu kërkua:

i) Të japë sqarimet në lidhje me pretendimet e denoncuesit, duke paraqitur aktet e dosjes së mosfillimit të kallëzimit nr. \*\*\*, si dhe vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që ka shqyrtuar këtë mosfillim dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 18.11.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili ka shfuqizuar vendimin e mosfillimit datë 19.11.2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

ii) Në lidhje me kallëzimet penale të shtetasit N. Rr. D., për të cilat është vendosur: në datën 5.3.2015 mosfillimi i procedimit të kallëzimit penal nr. \*\*\*; në datën 5.3.2015 mosfillimi i procedimit të kallëzimit penal nr. \*\*\*; në datën 5.3.2015 mosfillimi i procedimit të kallëzimit penal nr. \*\*\* – subjektit iu kërkua informacion mbi vijimësinë e këtyre vendimeve, nëse janë të ankimuar në gjykatë ose jo dhe sipas rastit çfarë është vendosur nga gjykata, duke paraqitur dokumentacion provues.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti dha sqarime të përgjithshme sa i takon veprimeve hetimore dhe gjyqësore në lidhje me kallëzimet e denoncuesit. Konkretisht:

*Së pari*, në lidhje me mosfillimin e kallëzimit penal nr. \*\*\*, sqaroi se pas shqyrtimit të akteve të materialit kallëzues dhe konstatimit që Prokuroria e Rrethit Fier kishte kryer hetime më parë në kuadër të procedimit nr. \*\*\*, si dhe faktit që vendimi i pushimit ishte ankimuar dhe po shqyrtohej në Gjykatën e Apelit Vlorë, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në datën

19.11.2014. Kallëzuesi e ka ankimuar vendimin e mosfillimit dhe Gjykata e Shkallës së Parë e, më tej, Gjykata e Apelit kanë vendosur që të regjistrohej procedimi penal e të kryheshin hetime. Procedimi penal është regjistruar në datën 13.12.2015, me nr. \*\*\*. Gjatë kësaj periudhe shtetasi N. D. ka depozituar kallëzim penal edhe ndaj tij si prokuror i çështjes. Në ato rrethana, për një hetim të drejtë dhe për të shmangur pretendimet për njëanshmëri në hetim, ka kërkuar që të zëvendësohet nga hetimi i çështjes, e cila është miratuar nga drejtuesi i Prokurorisë, duke ngarkuar një prokuror tjetër në hetimin e procedimit penal nr. \*\*\*, që në përfundim të hetimeve ka vendosur pushimin.

Në mbështetje të sqarimeve të tij, subjekti paraqiti dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*, për kallëzimin penal nr. \*\*\*.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes rezultoi se:

- Shtetasi N. D. ka paraqitur kallëzim penal nr. \*\*\* ndaj shtetasit K. K. për deklaram të rremë para noterit, si dhe deklaram të rremë para oficerit të policisë gjyqësore, për të cilin në datën 19.11.2014 është vendosur mosfillim nga prokurori Artur Cara, me arsyetimin se për të njëjtin fakt ka paraqitur kallëzim dhe është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, i cili është pushuar dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin datë 11.11.2014 dhe se hetimi sërish do të përbënte cenimin e parimit të gjësë së gjykuar. Bazuar në nenet 24.2, 290, shkronja “e” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal. Ky vendim është ankimuar nga kallëzuesit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.6.2015, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të datës 19.11.2014, për mosfillimin e procedimit të kallëzimit nr. \*\*\* dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në vendimin nr. \*\*\*, datë 22.6.2015, ka parashtruar se: Objekti i procedimit penal nr. \*\*\* ka qenë pretendimi i kallëzuesit N. D. në lidhje me AMTP-në në emër të shtetasit S. K., shpërdorim i detyrës. Për këtë procedim Prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “shpërdorimi i detyrës”. Ky vendim është ankimuar në gjykata dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të pushimit nr. \*\*\*. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit dhe çështja është në gjykim. Bazuar në sa më sipër, Prokuroria ka argumentuar se fakti konkret i kallëzimit penal nr. \*\*\* është hetuar nga ana e Prokurorisë në kuadër të procedimit nr. \*\*\* dhe hetimi sërish do të përbënte cenimin e parimit *res judicata*, për sa kohë që vendimi nr. \*\*\* është ende në fuqi.

Në arsyetimin e saj, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera, gjykata ka arsyetuar se:

a) Vendimi për mosfillim i procedimit për kallëzimin nr. \*\*\*, është i pabazuar në ligj, po kështu edhe referenca ligjore e bazueshmërisë, për shkak se në rastin objekt shqyrtimi hetimi lidhur me kallëzimin penal nr. \*\*\* nuk është kryer i plotë. Prokuroria nuk ka kryer asnjë veprim hetimor dhe nuk janë administruar aktet shkresore përkatëse pasqyruese të këtyre veprimeve, për verifikimin e kallëzimit të kërkuarit, duke pretenduar se ndodhemi para faktit të gjësë së gjykuar.

b) Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese është shprehur se *kriteri “e njëjta veprë” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, veprë penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj veprë dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar*. Në këtë rast është

fjala kur si sjellja ashtu edhe krimi bëhen për të njëjtat fakte të ndodhura në të njëjtën kohë dhe që cilësohen njëllor nga ligji; vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes nuk mund të konsiderohet si vendim i formës së prerë dhe i paankimueshëm gjyqësisht. Vendimi i pushimit të çështjes nga prokurori nuk përben dhënie drejtësie, kjo e fundit është kompetencë vetëm e gjykatës.

c) Në rastin konkret nuk ndodhemi para gjësë së gjykuar, pasi vendimi për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* është një vendim i prokurorit, i ankimuar dhe për të cilin gjykata e apelit nuk është shprehur ende.

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është bërë ankim nga Prokuroria dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.11.2015, ka vendosur lënien në fuqi. Më pas, subjekti i rivlerësimit, bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit, me datë 31.12.2015, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*. Në vijim, subjekti ka kërkuar zëvendësimin e tij në hetimin e këtij procedimi, për të mënjeluar çdo paragjykim për njëanshmëri, duke argumentuar se kallëzuesi në vitin 2015 ka paraqitur edhe tri kallëzime me nr. \*\*, \*\* dhe \*\*, si dhe ka paraqitur kallëzim ndaj tij për të cilin Prokuroria e Krimeve të Renda ka vendosur mosfillimin me datë 15.12.2015. Në vijim, drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e subjektit me prokuroren E. H. Kjo e fundit, në përfundim të hetimeve, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.

*Së dyti*, sa i takon vendimeve të mosfillimeve të kallëzimeve penale nr. \*\*, nr. \*\* dhe nr. \*\*, subjekti dha shpjegimet e tij për vijimësinë e tyre, sipas të cilave:

- Për kallëzimin nr. \*\* kallëzuesi e ka ankimuar vendimin e mosfillimit dhe Gjykata e Shkallës së Parë e, më tej, Gjykata e Apelit ka vendosur që të regjistrohej procedimi penal e të kryheshin hetime, i cili është regjistruar me nr. \*\*. Me kërkesë të tij, subjekti është zëvendësuar në hetimin e këtij procedimi.

- Për kallëzimin nr. \*\* kallëzuesi e ka ankimuar vendimin e mosfillimit dhe Gjykata e Shkallës së Parë e, më tej, Gjykata e Apelit ka vendosur që të regjistrohej procedimi penal e të kryheshin hetime, i cili është regjistruar me nr. \*\*. Me kërkesë të tij, subjekti është zëvendësuar në hetimin e këtij procedimi.

- Për kallëzimin nr. \*\* kallëzuesi e ka ankimuar vendimin e mosfillimit dhe Gjykata e Shkallës së Parë e, më tej, Gjykata e Apelit ka vendosur që të regjistrohej procedimi penal e të kryheshin hetime, i cili është regjistruar me nr. \*\*. Me kërkesë të tij, subjekti është zëvendësuar në hetimin e këtij procedimi. Ky procedim është bashkuar me procedimin nr. \*\*.

Në mbështetje të sqarimeve, ndër të tjera, subjekti paraqiti: vendimin nr. \*\*, datë 15.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*, datë 24.5.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë; vendimin nr. \*\*, datë 20.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*, datë 17.3.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë; vendimin nr. \*\*, datë 23.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*, datë 18.2.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Nga shqyrtimi i këtyre vendimeve Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin e shfuqizimit të vendimit të mosfillimit të procedimit për kallëzimin nr. \*\*.

Sa më sipër, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me sa duket se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor dhe nuk ka administruar aktet shkresore përkatëse pasqyruese të këtyre veprimeve për verifikimin e kallëzimeve nr. \*\*, nr.

\*\*\*, nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, duke arsyetuar se ndodhemi para faktit të gjësë së gjykuar. Ky arsyetim nuk bazohet në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në parashtrimet e tij subjekti dha të njëjtat sqarime si në përgjigje të pyetësorit nr. 2, që në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në faktin që, sipas tij, pretendimet e kallëzuesit ishin hetuar, konkluduar me vendim nga prokurori dhe në shqyrtim në Gjykatën e Apelit, pavarësisht se nuk kishte ende një vendim gjyqësor të formës së prerë, ai ka vlerësuar se hetimi paralel për të njëjtin fakt penal do të ishte në cenim të garancisë së sigurisë juridike dhe respektimit të të drejtave dhe lirisë së individit.

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit. Në analizë të parashtrimeve të tij, subjekti mban të njëjtin qëndrim që, siç rezultoi me vendim të formës së prerë, janë gjetur të pabazuara nga gjykata.

Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e Komisionit, por duke mbajtur në konsideratë sa parashikohet nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese *“Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore të përsëritura dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”*, vlerëson se ky denoncim i vetëm nuk mund të shërbejë si provë për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit.

### **34.2 Dy denoncime nga \*\*\*-Patos, G. T.**

Denoncuesi ngre pretendime ndaj disa gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku në denoncim përmendet edhe subjekti i rivlerësimit, z. Artur Cara, për përndjekje të paligjshme ndaj tij dhe favorizim i krimin të organizuar apo edhe zvarritje në lidhje me kallëzimin nr. \*\*\*. Nga shqyrtimi i denoncimit, denoncuesi nuk ngre ndonjë pretendim konkret ndaj subjektit të rivlerësimit apo shkelje ligjore konkrete ndaj tij apo të ketë paraqitur vendim të marrë nga subjekti i rivlerësimit. Ndër dokumentet e paraqitura denoncimeve, ndodhet vendimi nr. \*\*\*, datë 22.10.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë, me anë të të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. \*\*\*, datë 1.7.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me anë të të cilit është vendosur mospranimi i kërkesës së \*\*\*-Patos për zvarritje të hetimit të procedimit penal nr. \*\*\*, që i përket kallëzimit nr. \*\*\* nga prokurorët e çështjes. Sipas këtij vendimi nuk rezulton të jetë përmendur emri i subjekti të rivlerësimit, por disa prokurorë të tjerë. Sa më sipër, në denoncim nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë të dhënë për shkelje ligjore apo rrethana për faktet që të ketë pasur shkelje ligjore nga subjekti i rivlerësimit.

### **34.3 Denoncim<sup>10</sup> nga shtetasi S. M.**

Denoncuesi në thelb ngre pretendime në lidhje me veprimtarinë e gjyqtarëve dhe funksionarëve të Gjykatës Administrative Vlorë, por nuk ngre asnjë pretendim në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Artur Cara. Nga përmbajtja e denoncimit rezulton se shtetasi S. M. ka paraqitur kërkesë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë për marrje aktesh në disa dosje penale, përfshirë edhe një vendim të procedimit të vitit 2012 të prokurorit Artur Cara. Denoncuesi nuk

<sup>10</sup> Shihni denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 3.10.2019, në dosjen e Komisionit.

ka paraqitur ndonjë të dhënë për shkelje ligjore apo rrethana për faktet që të ketë pasur shkelje ligjore nga subjekti i rivlerësimit.

#### **34.4 Denoncim nga shtetasja R. K. (M. K.)**

Denoncuesi në thelb ngre pretendime që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Cara. Sipas denoncuesit ka marrë një vendim të pabazuar në prova dhe fakte. Bashkëngjitur ka paraqitur edhe vendimin datë 31.7.2017 të prokurorit Artur Cara, me anë të të cilit është vendosur pushimi i çështjes penale nr. \*\*\* dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2017, me të cilën është njoftuar shtetasi M. K. me vendimin e pushimit. Nga denoncimi nuk rezulton që ky vendim të jetë ankimuar nga ana e denoncuesit. Këto rrethana, pretendimet bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 84/2016, dalin jashtë tagrit të Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit, themelin e çështjes apo të vlerësojë interpretimin ose logjikën e prokurorit.

#### **Informacione të tjera**

**35.** Prokuroria e Përgjithshme<sup>11</sup> ka përcjellë informacion nga prokuroritë e rretheve, nga të cilat rezultoi se: (i) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, për të cilin është vendosur mosfillim procedimi; (ii) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, për të cilin është vendosur mosfillimi; (iii) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës është regjistruar materiali hetimor nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, për të cilat është vendosur mosfillim procedimi.

**36.** Ministria e Drejtësisë<sup>12</sup> ka përcjellë raportin mbi kontrollin në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën 12.11.2012 – 28.12.2013, për verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorëve në çështjet e mosfilluara dhe të pushuara, si dhe ecurinë e politikës penale në çështjet e dërguara në gjykim. Nga shqyrtimi i këtij raporti, sa i takon subjektit të rivlerësimit, z. Artur Cara, vërehet se:

i) Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorëve në procedimet penale të mosfilluara nuk është konstatuar ndonjë mangësi për subjektin e rivlerësimit.

ii) Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorëve në procedimet penale të pushuara, sa i takon subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*, pa emër personi nën hetim, është konstatuar se: *Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 2.9.2011, është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, i paraqitur nga Bashkia Fier, me anë të të cilit pretendohet se përmbaruesi E. M. dhe drejtori i thesarit I. M. kanë shpërdoruar detyrën. Në datën 10.11.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve. Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit me datë 23.5.2011. Nga analiza e akteve të këtij procedimi rezulton se nuk është respektuar vijueshmëria e veprimeve hetimore, pasi ka periudha të gjata kohore gjatë të cilave pa asnjë shkak të ligjshëm nuk janë kryer veprime hetimore, duke përfshirë zvarritje. Hetimi nuk ka qenë kompleks, ka pasur periudha prej 2-3 muaj pa kryer asnjë veprim hetimor. Sa më sipër, rezulton se prokurori Artur Cara nuk ka administruar dhe menaxhuar drejt kohën dhe procesin hetimor për të qenë efikas. Janë zvarritur hetimet jashtë një afati të arsyeshëm ligjor.*

iii) Në lidhje me ecurinë e politikës penale, e në veçanti e politikës së dënimit të ndjekur nga prokurori, është konstatuar se nuk është ndjekur politikë e drejtë penale, pasi është ndjekur

<sup>11</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

<sup>12</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2023, të Ministrisë së Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.



politikë e butë dënimi, nuk janë kundërshtuar vendimet kur kanë qenë në kundërshtim. Konkretisht është konstatuar si vijon:

- Në datën 2.12.2011, prokurori i Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal ndaj të pandehurit N. H. Ky procedim ka përfunduar me vendimin e dërgimit në gjyq me datë 30.12.2011. Prokurori, në konkluzionet përfundimtare, ka kërkuar: (1) deklarinin fajtor të të pandehurit N. H. për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim e 400.000 lekë gjobë; (2) deklarinin fajtor të të pandehurit N. H. për veprën penale “falsifikim të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave” dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim e 700.000 lekë gjobë; (3) deklarinin fajtor të të pandehurit N. H. për veprën penale “falsifikim të vulave, stampave apo formularëve” dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim e 600.000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale sugjeron uljen e 1/3 e dënimit.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.3.2012, ka vendosur: (1) deklarinin fajtor të të pandehurit N. H. për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, dënimin e tij me 3 muaj dërgim e 400.000 lekë gjobë; (2) deklarinin fajtor të të pandehurit N. H. për veprën penale “falsifikim të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”, dënimin e tij me 6 muaj burgim e 700.000 leke gjobë; (3) deklarinin fajtor të të pandehurit N. H. për veprën penale “falsifikim të vulave, stampave apo formularëve”, dënimin e tij me 6 muaj burgim e 600.000 lekë gjobë. Në bashkim të dënimeve, të dënojë të pandehurin me një vendim të vetëm prej 6 muaj burgim e 900.000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 4 muaj burg e 600.000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 59 urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit për një periudhë prej 2 vitesh. Ndaj këtij vendimi prokurori nuk ka bërë ankim.

- Nga analiza e fakteve nxirret përfundimi se prokurori Artur Cara duhet të kishte ushtruar ankim nda vendimit të mësipërm, lidhur me aplikimin e nenit 59<sup>13</sup> të Kodit Penal. I pandehuri akuzohet për tri vepra penale shoqërisht të rrezikshme; vetë prokurori ka argumentuar se rrezikshmëria shoqërore e të pandehurit është mesatare. Sa më sipër, prokurori duhet të kishte mbrojtur qëndrimin e tij duke ankimuar vendimin e gjykatës, pasi nuk rezultojnë asnjë nga rrethanat e parashikuara nga neni 59 i Kodit Penal. I pandehuri është me shtetësi maqedonase dhe gjykimi me dëshirën e tij është bërë në mungesë, rrethana këto që vënë në dyshim zbatimin e detyrimeve të vendosura nga gjykata. Ky qëndrim bie ndesh me udhëzimin<sup>14</sup> nr. 1, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, pika 1.1, germa “a”, ku përcaktohet se prokurori duhet të ushtrojë apel kur gjykata ka vendosur në kundërshtim me konkluzionet e përfundimtare në lidhje me alternativat e ekzekutimit të dënimit.

**37.** Në përfundim të këtij raporti, ndër të tjera, është rekomanduar fillimi i procedimit disiplinor për prokurorët, veprimtaria e të cilëve është me shkelje të detyrës, duke marrë në konsideratë parimin e proporcionalitetit dhe pasojës së ardhur nga shkeljet e kryera.

<sup>13</sup> Neni 59 i Kodit Penal parashikon se: “Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burgim gjer në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë duke u pezulluar ekzekutimi i dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale po aq të rëndë apo më të rëndë. Afati i provës është 18 muaj gjer në 5 vjet”.

<sup>14</sup> “Prokurori i seancës, në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, si rregull, duhet të ushtrojë apel kur Gjykata ka vendosur në kundërshtim me konkluzionet e tij përfundimtare apo me kërkesën e tij lidhur me: a. Alternativat e ekzekutimit të dënimit, të parashikuara në Kodin Penal”.

**38.** Subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konstatimet e mësipërme, si dhe të informojë nëse ka pasur procedim disiplinor ndaj tij dhe eventualisht vendimmarrjen përkatëse, duke e shoqëruar me dokumentacion.

**39.** Në parashtrimet e tij, në mënyrë të përmbledhur, subjekti sqaroi si vijon:

- Në lidhje me konstatimin e dytë të raportit të Ministrisë, subjekti sqaroi se vijueshmëria e kryerjes së veprimeve hetimore nga Policia Gjyqësore lidhet edhe me volumin e dosjeve në hetim dhe nga inspektimi i Ministrisë së Drejtësisë ka qenë vetëm kjo dosje e evidentuar për sa i përket menaxhimit dhe efikasitetit në hetim nga ana e tij.

- Në lidhje me konstatimin e tretë të raportit të Ministrisë, subjekti sqaroi se referuar rrethanave të gjykimit, masës së ulët të dënimit dhe ekzistencës së kriterëve ligjore, që nuk pengonin aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, ka vlerësuar në rastin konkret që të mos ankimojë vendimin.

- Në lidhje me faktin nëse ka pasur procedim disiplinor, subjekti sqaroi se ai ka pasur vetëm dy rastet e trajtuara më lart për gjithë periudhën e përfshirë në inspektim, të cilat nuk janë konsideruar për nisje të procedurave për procedim disiplinor. Ai shpjegoi se në raportin e vlerësimit të aftësisë profesionale, por edhe në konfirmimin e KLP-së me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2023, në dosjen e tij personale nuk rezulton të ketë vendim për marrje të masës disiplinore apo kërkesë për fillim të procedimit disiplinor.

**40.** Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancë dëgjimore, konstaton se subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me këtë denoncim.

#### **Qëndrimi i Komisionit mbi denoncimet**

**41.** Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e prokurorit.

**42.** Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se ai nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e Komisionit dhe me denoncimin e denoncuesit N. Rr. D., por duke mbajtur në konsideratë sa parashikohet nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, vlerëson se për sa ky ishte një rast i vetëm, ai nuk shërben si provë për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Cara:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në

bazë të nenit 51, shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Cara, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.7.2023.

#### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**  
**Kryesuese**

**Firdes SHULI**  
**Relatore/Kundër**

**Olsi KOMICI**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Gledis Hajdini*